



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

“MBI KOMUNIKIMIN ME INVESTITORËT”

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 133, datë 30.09.2020

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e kërkesave për dhënien e informacionit për investitorët nga shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike. Rregullorja trajton si më poshtë:
 - a) Parimet e përgjithshme për transparencën në veprimtarinë promovionale, marketimin dhe informimin për investitorët;
 - b) Përmbajtjen e informacionit të kërkuar dhe kushtet që duhet të përmbushen për dhënien e informacionit në:
 - i. Prospektin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
 - ii. Dokumentin e informacionit kryesor për investitorët.
 - c) Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme për investitorët;
 - d) Trajtimin e ankesave.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 16, 86, 87, 90, 92, 93, 97, 98, 99, 100, 109, 121-129, Seksioni 2 dhe 3 të Kreut VI, Kreut IX, neneve 155-157 dhe pikës 5 të nenit 195 të Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Neni 3

Përkufizimet

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin Nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
2. “Ligji” është Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
3. “Shoqëria administruese e portofolit” është shoqëria komisionere sipas ligjit “Për tregjet e kapitalit”, ose shoqëria administruese që ka të drejtë për të administruar portofolin.
4. “Transaksionet e financimit të titujve” janë (a) marrëveshjet e riblerjes së titujve (*repurchase transactions*); (b) huadhënia/huamarrja e titujve ose mallrave (*securities or commodities lending and securities or commodities borrowing*); (c) transaksionet e blerjes dhe shitjeve mbrapsht (*buy-sell back transaction or sell-buy back transaction*); (d) transaksione të huamarrjes me marzh (*a margin lending transaction*);

Neni 4

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore përcakton kërkesat për komunikimin me investitorët në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Dhënia e informacioneve të detyrueshme për investitorët të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike

Dhënia e informacioneve të detyrueshme investitorëve ose investitorëve potencialë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike kryhet sipas kërkesave të nenit 123 të Ligjit dhe sipas kësaj rregulloreje.

KREU II
MARKETIMI DHE VEPRIMTARIA PROMOCIONALE

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 6

Parimet dhe kriteret që zbatohen nga shoqëria administruese e fondeve për dhënien e informacionit në veprimtari promociionale për investitorët.

1. Të gjitha veprimtaritë promociionale duhet të përputhen me prospektin SIK të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose të nënfondit në fjalë dhe duhet të jenë të qarta, të rregullta dhe jo keqorientuese.
2. Veprimtaritë promociionale nuk duhet të përmbajnë të dhëna që bien ndesh ose zvogëlojnë rëndësinë e informacioneve të prospektit të SIK dhe të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin.
3. Në rastin e veprimtarive promociionale për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike dhe shoqërive të tyre administruese duhet të përmbushen kriteret e mëposhtme:
 - a) Qëllimi i marketimit nuk duhet të fshihet apo prezantohet në mënyrë mashtruese;
 - b) Paraqitet një përshkrim i saktë dhe i vërtetë i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që po promovohet, si dhe i detyrimeve të pritshme dhe i rreziqeve që lidhen me to;
 - c) Faktet dhe kuotimet e dhëna duhet të jenë të sakta, të qarta, të vërteta dhe të kuptueshme, në datën në të cilën jepen, si dhe nuk duhet të jenë çorientuese dhe çdo fakt i dhënë të jetë i vërtetueshëm;
 - ç) Kuotimi i dhënë sipas shkronjës “c”, të kësaj pike, të jetë i plotë dhe i qartë dhe të shprehet se për përdorimin e mëtejshëm të tij është marrë miratimi nga shoqëria administruese, si dhe;
 - d) Çdo krahasim i bërë të bazohet në fakte, të cilat janë të sakta dhe të përditësuara. Gjithashtu përfundimet kryesore të këtyre krahasimeve duhet të jepen në mënyrë të qartë dhe çdo krahasim të jepet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, i cili, në asnjë mënyrë nuk është çorientues dhe bazohet në të gjithë faktorët kyç për një krahasim të këtij lloji;
 - dh) Nuk duhet të jepet asnjë keqprezantim në veçanti për sa i përket njohurive profesionale të personave përgjegjës, aktiveve dhe qëllimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe veprimtarisë tregtare të shoqërisë administruese dhe pronësisë apo numrit të aksioneve apo të kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike;

- e) Të garantohet që paraqitja, përmbajtja ose forma e informacionit të reklamave nuk shtrembëron, fsheh apo ul rëndësinë e deklaratave, paralajmërimeve ose referencave, që jepen sipas këtij ligji apo aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij;
 - ë) Të garantohet që asnjë licencë e dhënë nga autoriteti rregullator të mos citohet pa lejen e këtij autoriteti, si dhe duhet të garantohet se asnjë palë e tretë të mos besojë që licenca e dhënë nga autoriteti rregullator ka kuptim të ndryshëm nga certifikata që vërteton se subjekti në fjalë ka përmbushur të gjitha kushtet për përfitimin e statusit ligjor të treguar në licencë, për të treguar kujdesin e duhur për të shmangur çdo keqinterpretim të fushëveprimit të licencës të dhënë nga Autoriteti;
 - f) Duhet të përfshihet çdo e dhënë, nëse mospërfshirja e saj do ta bënte veprimtarinë promovionale të pasaktë, të pavërtetë, të paqartë ose çorientuese.
4. Çdo veprimtari promovionale në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive ose nënfondet i përdorur për qëllime marketimi duhet të përfshijë qartazi këto specifikime:
- a) Investimi në një sipërmarrje investimesh kolektive ose nënfond nuk është një investim i garantuar;
 - b) Nuk ka asnjë garanci nga palët e treta të stabilitetit të vlerës neto të aktiveve për aksion ose kuotë;
 - c) Rreziku i humbjes së principalit përballohet nga investitori;
 - d) Vlera neto e aktiveve për aksion ose kuotë mund të ulet dhe të rritet dhe investitorët mund të mos rimarrin shumën që kanë investuar;
 - e) Aksionet dhe kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave.
5. Kur sipërmarrja ose nënfondi i licencuar përsërit një indeks të aksioneve ose letrave me vlerë të borxhit, veprimtaritë promovionale të saj duhet të përfshijnë një deklaratë të qartë duke nënvizuar politikën e saj të investimeve.
6. Kur vlera neto e aktiveve për kuotë të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondit të saj ka gjasë të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të karakteristikës që kanë aktivet në përbërje të portofolit ose teknikave të administrimit të portofolit që mund të përdoren, veprimtaritë promovionale duhet të përfshijnë një deklaratë të qartë duke nënvizuar këtë karakteristikë të sipërmarrjes.
7. Të gjitha veprimtaritë promovionale bëjnë të ditur se ekziston prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin. Ato përcaktojnë vendin dhe në cilën gjuhë mund të gjenden këto dokumente dhe si mund të aksesohen.

Neni 7

Miratimi i veprimtarive promociionale dhe ruajtja e të dhënave

1. Të gjitha veprimtaritë promociionale të publikuara në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike miratohen nga një person kyç i shoqërisë administruese në emër të shoqërisë administruese të licencuar.
2. Shoqëria administruese ruan të dhënat në lidhje me çdo veprimtari promociionale, së bashku me burimet e informacioneve të publikuara, sipas periudhës kohore që parashikohet në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Këto të dhëna i vihen në dispozicion Autoritetit për çdo inspektim të mundshëm.
3. Këto të dhëna përfshijnë së paku një kopje të çdo veprimtarie promociionale të botuar, së bashku me datat e botimit dhe detajet e mediave në të cilat është publikuar çdo veprimtari promociionale.

SEKSIONI 2

PARAQITJA E KTHIMIT TË INVESTIMEVE

Neni 8

Parimet që zbatohen për paraqitjen e kthimit të investimeve

1. Paraqitja e kthimeve nga investimi i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:
 - a) Nuk përbën garanci ose premtim;
 - b) Nuk kryhet në formën e vlerësimeve të përafërta në asnjë lloj forme vlerësimi;
 - c) Reflekton performancën e investimit nga çasti i themelimit të saj deri në ditën e paraqitjes, e cila paraqitet për çdo vit dhe në formë kumulative ose performancën në pesë vitet e fundit, cilado nga të dy periudhat është më e shkurtër, por jo më pak se një vit;
 - ç) Bëhet në bazë të dhënave më të fundit, të disponuara në çastin e paraqitjes së kthimeve të fondit të investimeve;
 - d) Hartohet në mënyrë të standardizuar për sa u përket periudhave të mbuluara, me përfshirjen ose përjashtimin e faktorëve të caktuar, që prekin këto rezultate (si, për shembull, bazën për çmimin, kostot, taksat, dividendët);
 - dh) Nuk duhet të paraqitet në mënyrë që të interpretohet si parashikim për rezultatet e mundshme të veprimtarisë në të ardhmen.

2. Çdo dokument i publikuar/botuar në kuadrin e veprimtarisë promovionale që përmban paraqitjen e kthimeve të investimeve duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a) Kthimet e investimeve për një periudhë më të shkurtër se një vit nuk mund të paraqiten;
 - b) Për sipërmarrjet e investimeve kolektive që kanë kryer aktivitet më pak se një vit, kthimet nga investimi duhet të shfaqen deri në fund të tremujorit më të fundit para publikimit të dokumentit;
 - c) Kthimet e investimeve duhet të tregohen për një minimum prej 5 vjetësh ose që nga fillimi i sipërmarrjes ose nënfondit cilado që është më e shkurtër;
 - d) Nëse janë paraqitur kthimet kumulative të investimeve për një periudhë të caktuar, duhet të paraqitet edhe norma e rritjes në përqindje për çdo vit të periudhës kumulative;
 - e) Periudha e referencës për të cilën citohet performanca dhe burimi i të dhënave deklarohen qartë;
 - f) Nëse kthimet e investimit të paraqitura mbështeten në shifra të shprehura në një monedhë të ndryshme nga leku shqiptar, kur aksionet ose kuotat e sipërmarrjes janë shprehur në lekë, monedha duhet shprehur qartë, së bashku me paralajmërimin se kthimi mund të rritet ose të ulet si rezultat i luhatjeve të monedhës;
 - g) Nëse kthimi i investimeve bazohet në performancën bruto, duhet të paraqitet efekti i komisioneve, tarifave ose pagesave të tjera.
3. Përqindja e normës së rritjes (pnrr) e përmendur në pikën 2, shkronja d) të këtij neni për një sipërmarrje të licencuar me pjesëmarrje të hapur ose me interval është përqindja e normës së rritjes për vitin, ku: $pnrr = ((P1 - P0) / P0) * 100$ dhe e rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore dhe ku P0 është çmimi i kuotës në fillim të periudhës 12-mujore dhe P1 është çmimi i kuotës në të njëjtën ditë në periudhën 12 mujore pasardhëse.
4. Çmimi në P1 duhet të korrigjohet me çdo kosto që ka lindur nga data P0 të cilat bazohen mbi një pjesë të sipërmarrjes ose nënfondit dhe tarifohen gjatë anulimit të kuotave.
5. Përqindja e normës së rritjes (pnrr) e përmendur në pikën 2, shkronja d) të këtij neni për një sipërmarrje të licencuar me pjesëmarrje të mbyllur është përqindja e normës së rritjes për vitin, ku: $pnrr = ((N1 - N0) / N0) * 100$ dhe e rumbullakosur dhe e rumbullakosur deri në dy shifra pas presjes dhjetore dhe ku N0 është çmimi i aksionit ose kuotës në fillim të periudhës 12-mujore dhe N1 është çmimi i aksionit ose kuotës në të njëjtën ditë në periudhën 12 mujore pasardhëse.
6. Vlera neto e aktiveve në N1 korrigjohet me çdo kosto që ka lindur nga data N0 të cilat bazohen mbi një pjesë të sipërmarrjes ose nënfondit dhe që tarifohen gjatë anulimit të aksioneve ose kuotave.

KREU III
PROSPEKTI SIK

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 9

Kërkesa për prospektin SIK

1. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike e themeluar në Republikën e Shqipërisë nuk nis veprimtarinë e saj nëse prospekti SIK i sipërmarrjes nuk miratohet paraprakisht nga autoriteti.
2. Çdo sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike e themeluar në Republikën e Shqipërisë harton dhe përgatit një prospekt SIK. Në rastin e sipërmarrjes ombrellë prospekti SIK përmbush kërkesat e mëposhtme:
 - a) Informacioni në prospektin SIK jepet në lidhje me çdo nënfond në rast kur informacionet për këtë nënfond janë të ndryshme nga informacionet për nënfondet e tjera; dhe
 - b) Për sipërmarrjen ombrellë në tërësi, por vetëm kur informacioni ka të bëjë me sipërmarrjen ombrellë në tërësi.
3. Prospekti SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive të themeluar në Republikën e Shqipërisë përmban informacion nëse sipërmarrja është:
 - a) Fond investimesh ose shoqëri investimesh;
 - b) Në rastin e fondit të investimeve, nëse është sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, sipërmarrje me intervale ose sipërmarrje me pjesëmarrje të mbyllur;
 - c) Në rastin e sipërmarrjes me pjesëmarrje të hapur, nëse është sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike ose sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm;
 - ç) Sipërmarrje e veçantë ose sipërmarrje ombrellë;
 - d) Në rastin e sipërmarrjes ombrellë, emrat dhe objektivat e investimit të nënfondeve;
 - dh) Sipërmarrje kryesore;
 - e) Sipërmarrje furnizuese.
4. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike të themeluar në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe përcakton qartë statusin e licencimit të sipërmarrjes në bazë të këtij ligji dhe përcakton datën e publikimit të prospektit.

5. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban informacione, në veçanti për rreziqet që kanë lidhje me këtë pjesëmarrje, të cilat i nevojiten investitorëve me qëllim marrjen e një vendimi për t'u bërë pjesëmarrës i sipërmarrjes së investimeve kolektive.
6. Prospekti në vetvete nuk përbën një ftesë për të blerë aksione ose kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike, por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat, rreziqet për të qenë pjesë e sipërmarrjes së investimeve kolektive.
7. Prospekti duhet të jetë i qartë, i saktë dhe jo keqorientues e duhet të jetë i përditësuar.
8. Prospekti përmban një formular tip - kërkesë ku përfshihet deklarata për tu nënshkruar nga investitori i mundshëm, sipas së cilës investitori deklaron se i ka lexuar dhe i ka kuptuar kushtet e ofertës dhe rreziqet e përfshira.
9. Blerja e pjesëmarrjeve në sipërmarrjen e investimeve kolektive të përshkruar në prospekt nënkupton pranimin e kushteve të prospektit SIK.
10. Prospekti hartohet për emetimin fillestar të aksioneve të shoqërisë së investimeve dhe për çdo emetim të mëpasshëm.
11. Prospekti vihet në dispozicion nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi ose me anë të një faqe në internet. Një kopje në letër do t'i dorëzohet investitorëve me kërkesë dhe pa pagesë.
12. Prospekti për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike, përveç informacionit të kërkuar nga ky nen, duhet të përmbajë edhe informacionin e kërkuar në Seksionin II të këtij kreu dhe shtojcës 2 të kësaj rregullore.

SEKSIONI II PËRMBAJTJA E PROSPEKTIT SIK

Neni 10 Përmbajtja e prospektit SIK

1. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike përmban të paktën informacionet që kërkon shtojca 2 e kësaj rregulloreje.
2. Prospekti SIK informon se në cilat kategori të aktiveve është e autorizuar të investojë sipërmarrja.

3. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm investon kryesisht në çdo lloj kategorie aktivesh, të parashikuar në seksionin 3, të kreut VII, të Ligjit, përveçse në tituj të transferueshëm dhe instrumente (SIKTT/UCITS) të tregut të parasë ose replikon një indeks të aksioneve ose të instrumenteve të borxhit, në përputhje me shkronjën “j”, të pikës 3, të nenit 85, të Ligjit, prospekti i saj dhe, sipas rastit, marketimi ose veprimtaria promocionale përmban një deklaratë të qartë ku theksohet politika e investimit dhe, sipas rastit, fakti se sipërmarrja është fond i tregtuar në bursë.
4. Kur vlera neto e aktiveve për kuotë e një sipërmarrjeje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm me ofertë publike mund të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të përbërjes së portofolit ose të teknikave të administrimit të portofolit që mund të përdoren, prospekti SIK duhet të përfshijë një deklaratë të dukshme ku theksohet kjo karakteristikë e sipërmarrjes.
5. Shoqëria administruese jep edhe informacione shtesë lidhur me kufizimet sasiore që zbatohen në administrimin e rreziqeve të sipërmarrjes, mbi metodat e përzgjedhura për këtë qëllim dhe mbi zhvillimet e fundit të rreziqeve kryesore.
6. Prospekti përmban në mënyrë të dukshme një rubrikë të titulluar “Faktorët e rrezikut”, e cila përshkruan faktorët e rrezikut me rëndësi thelbësore të lidhura me sipërmarrjen. Kjo rubrikë duhet të përmbajë:
 - a) Një përshkrim të përgjithshëm të faktorëve të rrezikut, duke i detajuar ato më pas në kategori të veçanta;
 - b) Përshkrimin e faktorëve të rrezikut jo në formë deklarative, por ato duhet të jenë specifike dhe të përshkruara qartë. Faktorët e rrezikut nuk duhen të përshkruhen në një mënyrë që të përjashtojnë shoqërinë administruese nga përgjegjësia;
 - c) Aty ku është e mundur faktorët e rrezikut duhet të shoqërohen me shembuj.
7. Prospekti duhet të përmbajë edhe informacionet e mëposhtme:
 - a) Numrin dhe datën e licencës të dhënë nga Autoriteti për këtë sipërmarrje si dhe detajet përkatëse të përfundimit, nëse kohëzgjatja e sipërmarrjes së licencuar është e kufizuar;
 - b) Monedhën e saj bazë;
 - c) Informacion mbi të gjitha kostot dhe tarifatat që mbahen nga aktivet e SIK, mënyrën e llogaritjes së tyre si dhe nivelin maksimal të totalit të tyre;
 - d) Nëse shpenzimet mund të zbriten nga të ardhurat apo kapitali i SIK si dhe politikën e shpërndarjes së këtyre shpenzimeve;
 - e) Nëse të ardhurat shpërndahen apo ri investohen;
 - f) Në rastin e shoqërisë së investimit me pjesëmarrje të mbyllur, shumën maksimale dhe minimale të kapitalit të saj;
 - g) Rrethanat në të cilat sipërmarrja ose nënfondi mund të likuidohet ose të mbyllet sipas Ligjit dhe rregullores “Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe

likuidimin" dhe një përmbledhje të procedurës dhe të drejtat e aksionarëve ose mbajtësve të kuotave gjatë kësaj mbyllje ose likuidimi;

- h) Nëse është një sipërmarrje ombrellë siç përcaktohet në nenin 3, pika 4, shkronjën b) të Ligjit, një deklaratë që nënfondet e saj janë portofole të veçuara të aktiveve dhe për rrjedhojë, aktivet e një nënfondi i përkasin ekskluzivisht atij nënfondi dhe nuk do të përdoren për të shlyer drejtpërdrejt ose tërthorazi detyrimet ose pretendimet ndaj çdo personi ose organi tjetër, përfshirë ombrellën ose ndonjë fond tjetër.

Neni 11

Objektivat dhe politikat e investimeve

1. Prospekti i SIK duhet të përfshijë objektivat dhe politikat e investimit të sipërmarrjes ose të nënfondit duke përcaktuar sa më poshtë:
 - a) Nëse sipërmarrja ose nënfondi ka për qëllim të sigurojë të ardhura ose të arrijë rritjen e kapitalit, ose të sigurojë rritje të të ardhurave dhe kapitalit ose të arrijë ruajtjen e kapitalit;
 - b) Mënyrën e arritjes së objektivave të investimit, duke përfshirë natyrën e përgjithshme të portofolit dhe nëse është e përshtatshme, çdo instrument të synuar;
 - c) Specifikim për çdo kufizim të kësaj politike investimi;
 - d) Për një sipërmarrje ose nënfond, i cili ka deklaruar në emrin e vet, objektiva investimi ku synon të realizojë një nivel të caktuar të ardhurash, ose kthimi, (dhe ku nuk ka garanci për këto të ardhura), është e detyrueshme që në prospekt të ketë deklarata shtesë në lidhje me objektivat e investimit të sipërmarrjes ose nënfondit si në vijim:
 - i. Se kapitali është në rrezik dhe investitori mund të humbasë pjesë nga kapitali;
 - ii. Periudha e investimit gjatë së cilës sipërmarrja ose nënfondi synon të arrijë një kthim pozitiv; dhe
 - iii. Që nuk ka asnjë garanci se kjo do të arrihet gjatë asaj periudhe specifike, ose çdo periudhe kohore;
 - e) Përshkrimin e investimeve nga të cilat mund të përbëhet portofoli;
 - f) Synimin në përqindje të secilit lloj investimi që përbën portofolin;
 - g) Përshkrimin e transaksioneve që mund të kryhen në emër të sipërmarrjes ose nënfondit dhe një tregues të çdo përdorimi të derivateve ose teknikave dhe instrumenteve ose mundësitë huamarrëse që mund të përdoren në administrimin e sipërmarrjes;
 - h) Një listë të tregjeve të njohura përmes të cilave sipërmarrja mund të investojë ose të tregtojë sipas kreut VII të Ligjit dhe rregullores për investimet dhe huamarrjen;
 - i) Nëse investimi është në letra me vlerë të qeverisë dhe organeve publike atëherë duhet të përfshihet sa më poshtë:
 - i. Një deklaratë e qartë për faktin se më shumë se 35% e vlerës së aktiveve së sipërmarrjes janë ose mund të investohen në tituj të transferueshëm

- ose në instrumente të miratuara të tregut të parasë, të lëshuara ose të garantuara nga një shtet i vetëm, autoritet lokal ose organ publik ndërkombëtar;
- ii. Emrat e shteteve, autoriteteve rajonale ose lokale ose organeve publike ndërkombëtare që lëshojnë ose garantojnë titujt në të cilat mund të investohen më shumë se 35% të vlerës së aktiveve të sipërmarrjes;
- j) Për një sipërmarrje ose nënfond që mund të investojë në sipërmarrje ose nënfonde të tjera, masën në të cilën aktivet e sipërmarrjes mund të investohet në aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve ose nënfondeve të cilat administrohen nga shoqëria administruese e fondit ose nga një shoqëri, subjekti ose personi juridik me të cilin shoqëria administruese e fondit ka lidhje pronësie;
- k) Kur sipërmarrja ose nënfondi është një sipërmarrjeje furnizuese ose nënfond që investon kuotat në një sipërmarrje të vetme të investimeve kolektive ose nën fond (sipërmarrje ose nënfond kryesor), jep detaje të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor dhe minimumin e investimit (dhe, nëse është e zbatueshme, maksimumin) që sipërmarrja ose nënfondi furnizues kryejnë;
- l) Nëse sipërmarrja ose nënfondi investon kryesisht në kuota të sipërmarrjeve të tjera, ose në depozita ose përsërit një indeks, një deklaratë të qartë në lidhje me këtë politikë investimi;
- m) Nëse transaksionet e derivativëve përdoren në sipërmarrje ose në nënfond, një deklaratë të qartë nëse këto transaksione janë për qëllime të mbrojtjes (*hedging*);
- n) Informacion në lidhje me ecurinë historike të sipërmarrjes ose nënfondit për një periudhë prej 5 vjetësh ose që nga fillimi i sipërmarrjes ose nënfondit cilado është më e shkurtër;
- o) Për sipërmarrjen ose nënfondin që investon një pjesë të konsiderueshme të aktiveve të saj në sipërmarrje ose nënfonde të tjera, një deklaratë të nivelit maksimal të tarifave të administrimit që mund të tarifohen për këtë sipërmarrje ose nënfond dhe për sipërmarrjet ose nënfondet në të cilat investon;
- p) Nëse sipërmarrja është një sipërmarrje e investimeve kolektive të tregut të parasë, një deklaratë që e identifikon atë si një sipërmarrje të tillë dhe se si objektivat dhe politikat e investimit të sipërmarrjes synojnë të ruajnë vlerën neto të aktiveve të sipërmarrjes ose konstante (neto nga fitimet) ose në vlerën e kapitalit fillestar të pjesëmarrësve plus fitimet;
- q) Nëse vlera neto e aktiveve të sipërmarrjes ose një pjese të fondit mund të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të përbërjes së portofolit ose teknikave të administrimit të portofolit që mund të përdoren, një deklaratë e qartë duhet të përfshihet për këtë qëllim;
- r) Për sipërmarrjen me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, e cila është një sipërmarrje investimesh kolektive në tituj të transferueshëm, një deklaratë që çdo aksionar mund të marrë sipas kërkesës prospektin SIK, si dhe raportin dhe llogaritë vjetore;

- s) Për sipërmarrjen ose nënfondin që është ose ka për qëllim të jetë një sipërmarrje ose një nënfond kryesor, një deklaratë që nuk është sipërmarrje furnizuese dhe se nuk do të mbajë kuota të një sipërmarrjeje ose nënfondi furnizues.

Neni 12

Informacioni për të drejtat e lidhura me aksionet ose kuotat

1. Nëse ka më shumë se një klasë aksionesh ose kuotash në emetim ose gati për emetim, emrin e klasës dhe të drejtat që i bashkëngjiten secilës klasë, nëse ato ndryshojnë nga të drejtat që i bashkëngjiten klasave të tjera.
2. Nëse është e zbatueshme, si pjesëmarrësit ose mbajtësit e kuotave mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të votimit dhe vlerën e tyre.
3. Nëse kërkohet shlyerje, anulim ose konvertim i detyrueshëm i aksioneve ose kuotave nga njëra klasë në tjetrën, në çfarë rrethanash bëhet kjo kërkesë.

Neni 13

Transferimi i aksioneve ose kuotave

1. Prospekti duhet të përmbajë një deklaratë nëse transferimi i aksioneve ose kuotave në sipërmarrje është i ndaluar ose i lejuar nga dokumenti themelues i sipërmarrjes.
2. Nëse nënfondet individuale kanë politika të ndryshme në lidhje me transferimin e kuotave, në Prospekt kërkohen deklaratat të veçanta.

Neni 14

Personat dhe personeli kyç i shoqërisë administruese të fondit dhe shoqërisë së investimit

Përveçse sa parashikohet në pikën 1.8 të shtojcës 2 të kësaj rregulloreje, në lidhje me personat dhe personelin kyç të shoqërisë administruese të fondit dhe/ose të shoqërisë së investimit, në prospekt duhet të jepet edhe një deklaratë, nëse personi ose anëtari i personelit kyç të shoqërisë është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

Neni 15

Depozitari

1. Në përputhje me pikën 2 të shtojcës 2 të kësaj rregulloreje, informacioni në lidhje me depozitarin duhet të përmbajë:
 - a) Natyrën dhe formën e shoqërisë;
 - b) Adresën e selisë së regjistruar;
 - c) Adresën e zyrës së saj qendrore, nëse kjo është e ndryshme nga adresa e selisë së regjistruar;
 - d) Numrin e licencës së dhënë nga Autoriteti;
 - e) Përshkrimin e detyrave dhe konflikteve të interesit që mund të lindin ndërmjet depozitarit dhe:
 - i. Sipërmarrjes ose nënfondit;
 - ii. Aksionarëve ose mbajtësve të kuotave të sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - iii. Shoqërisë së administrimit të fondeve;
 - f) Përshkrimin e funksioneve të ruajtjes/kujdestarisë së depozitarit të deleguara dhe përshkrimin e çdo konflikti interesi që mund të lindë nga një delegim i tillë;
 - g) Listën që tregon identitetin e secilës palë të deleguar dhe nëndeleguar;
 - h) Deklaratën, që informacioni i përditësuar në lidhje me dispozitat e përcaktuara në shkronjat a), g) dhe h) të kësaj pike do të vihet në dispozicion të mbajtësve të kuotave me kërkesë të tyre, në rastin e sipërmarrjes së investimeve kolektive në tituj të transferueshëm.

Neni 16

Shoqëria administruese e portofolit

1. Nëse shoqëria administruese e portofolit individual kryen edhe veprimtarinë e menaxhimit të SIK, të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
 - a) Veprimtari të tjera të rëndësishme nëse ka, përveç ofrimit të shërbimeve për sipërmarrjen;
 - b) Statusi i licencimit dhe detajet e licencës dhe autoritetit rregullator.

Neni 17

Audituesi i jashtëm

1. Informacioni në lidhje me audituesin e jashtëm të shoqërisë administruese dhe sipërmarrjes duhet të përmbajë:
 - a) Adresën e tij;
 - b) Statusin i tij profesional;

- c) Emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare.

Neni 18

Informacion në lidhje me kontratat me palët e treta

1. Në prospekt duhet të jepet një informacion i përgjithshëm në lidhje me kontratat e lidhura me palët e treta:
 - a) Në rastin fondit të investimit, ndërmjet shoqërisë administruese të fondit të sipërmarrjes dhe depozitarit të sipërmarrjes;
 - b) Në rastin e shoqërisë së investimit, ndërmjet shoqërisë së investimit dhe shoqërisë administruese të fondit dhe shoqërisë së investimit dhe depozitarit, e cila mund të jetë e rëndësishme për aksionet ose mbajtësit e kuotave, duke përfshirë dispozitat që lidhen me shpërblimin e depozitarit.
2. Në rastin e ofrimit të shërbimeve nga shoqëria administruese e portofolit:
 - a) Një përmbledhje të dispozitave të rëndësishme të çdo kontrate midis shoqërisë administruese të fondit ose shoqërisë së investimit dhe çdo shoqëri administruese të portofolit që mund të jenë të rëndësishme për aksionet ose mbajtësit e kuotave;
 - b) Në rastin e ofrimit të shërbimeve nga shoqëria administruese e portofolit në lidhje me biznesin e sipërmarrjes, e cila ka autoritetin e shoqërisë administruese të fondit për të marrë vendime në emër të shoqërisë administruese të fondit, të përfshihen të dhëna mbi këtë fakt dhe një përshkrim të çështjeve në lidhje me të cilat ajo ka autoritetin.
3. Një listë të:
 - a) Funksioneve që shoqëria administruese e fondeve ka deleguar në përputhje me rregulloret e Autoritetit;
 - b) Personin juridik të cilit i janë deleguar këto funksione.
4. Listën e sipërmarrjeve të tjera të licencuara që administrohen nga shoqëria administruese.

Neni 19

Informacion mbi përgjegjësinë e mbajtjes së regjistrit të mbajtësve të kuotave

1. Prospekti duhet të përmbajë informacionin në lidhje me:
 - a) Përgjegjësinë e shoqërisë administruese për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit;
 - b) Përgjegjësinë e depozitarit për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit;
 - c) Adresat në Republikën e Shqipërisë ku mbahet regjistri i mbajtësve të kuotave ose aksionarëve.

Neni 20
Vlerësimi dhe çmimi i aktiveve

1. Në lidhje me vlerësimin e aktiveve të sipërmarrjes ose të nënfondit dhe aktiveve neto për kuotë në fondet e investimit të licencuara me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale të përfshihet një dispozitë që duhet të ketë një vlerësim të vetëm për çdo kuotë.
2. Rregullat për metodologjinë e vlerësimit të aktiveve duhet të përmbajnë:
 - a) Një përshkrim të përgjithshëm si do të përcaktohet vlera e aktiveve;
 - b) Sa shpesh dhe në cilën kohë të ditës aktivet vlerësohen rregullisht për qëllime të tregtimit dhe një përshkrim të çdo rrethane në të cilën mund të vlerësohen posaçërisht aktivet;
 - c) Nëse është e përshtatshme, si përcaktohet çmimi i kuotave të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale ose të nënfondeve të çdo klase të ndryshme për qëllime shitjeje dhe shlyerjeje;
 - d) Ku dhe sa shpesh do të publikohet vlera neto e aktiveve për kuotë;
 - e) Ku dhe sa shpesh do të publikohet vlera neto e aktiveve për aksion të një shoqërie investimi ose për kuotë të një fondi investimi me pjesëmarrje të mbyllur.

Neni 21
Shitja dhe shlyerja

1. Në prospekt duhet të përfshihen detajet e mëposhtme në lidhje me fondet e investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale:
 - a) Procedurat, periudhat e trajtimit në lidhje me:
 - i. Shitjen dhe shlyerjen e kuotave dhe shlyerjen për çdo klasë të kuotave në sipërmarrje;
 - ii. Krijimin ose anulimin e kuotave nga depozitari i sipërmarrjes;
 - b) Rrethanat dhe kushtet për emetimin e kuotave në sipërmarrje të cilat kufizojnë emetimin e çdo klase kuotash;
 - c) Rrethanat dhe procedurat për pezullimin e shlyerjeve.
2. Të përfshihen detajet e mëposhtme në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive të licencuara:
 - a) Nëse emetohen certifikata në lidhje me aksionet ose kuotat e regjistruara dhe nëse mbahet tarifë në lidhje me këtë, natyra dhe shuma e pagesës;
 - b) Rrethanat dhe procedurat e shoqërisë administruese të fondit për emetimin ose anulimin e kuotave sipas llojit;
 - c) Tregjet e rregulluara (nëse ka) në të cilat janë regjistruar ose tregtuar aksionet ose kuotat e sipërmarrjes.

3. Të përfshihet në prospektin e SIK gjatë periudhës së çdo oferte fillestare:
 - a) Kohëzgjatja e periudhës fillestare të ofertës;
 - b) Çmimi fillestar të aksionit ose kuotës, i cili duhet të jetë në monedhën bazë;
 - c) Procedurat për emetimin e aksioneve ose kuotave gjatë ofertës fillestare, duke përfshirë synimet e shoqërisë administruese të fondit për investimet e kryera gjatë ofertës fillestare;
 - d) Rrethanat kur oferta fillestare do të përfundojë;
 - e) Nëse aksionet ose kuotat do të shiten ose emetohen në ndonjë monedhë tjetër;
 - f) Çdo detaj tjetër të rëndësishëm të ofertës fillestare;
 - g) Kushtet që duhet të plotësohen me qëllim që të bëhet transferimi i aksioneve ose kuotave.

Neni 22

Çmimi i aplikueshëm për blerjen dhe shlyerjen e kuotave

1. Në lidhje me fondin e investimit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, të përfshihet një shpjegim i çmimit që do të aplikohet dhe një deklaratë që:
 - a) Asnjë kuotë nuk mund të shitet ose të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrit për blerjen ose shitjen e kuotave;
 - b) Se sa është koha e pritjes para pikës së vlerësimit.

Neni 23

Komisionet e hyrjes dhe daljes

1. Nëse është e zbatueshme, të deklarohej komisioni i hyrjes, duke specifikuar bazat dhe shumën aktuale apo shkallën e kësaj pagese.
2. Nëse është e zbatueshme, të deklarohej komisioni i daljes që do të zbritet nga shuma e shlyerjes duke përcaktuar:
 - a) Shumën e tanishme të komisionit ose nëse është e ndryshueshme, shkallën ose metodën e llogaritjes së saj;
 - b) Nëse shuma, përqindja ose metoda është ndryshuar, specifikim që detajet e çdo shume, përqindjeje ose metode të mëparshme mund të merren nga shoqëria administruese e fondeve sipas kërkesës;
 - c) Si duhet të përcaktohet rendi i kuotave të blera në kohë të ndryshme nga një mbajtës kuotash, për aq sa është e nevojshme për qëllimet e llogaritjes së komisionit të daljes.

Neni 24

Informacione të përgjithshme për investitorin

1. Prospekti duhet të përmbajë edhe informacionet e mëposhtme për investitorin:
 - a) Adresën ku mund të merren kopjet e dokumentit themelues, çdo dokumenti tjetër të amenduar dhe raportet dhe pasqyrat financiare më të fundit vjetore dhe të ndërmjetme të sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - b) Mënyrën sipas të cilës shpërndahet çdo njoftim ose dokument tek aksionarët ose mbajtësit e kuotave;
 - c) Rregullat mbi taksimin që ndikojnë në SIK;
 - d) Informacion mbi mbajtjen e tatimit për investitorët.

Neni 25

Sipërmarrjet ombrellë

1. Në rastin e një sipërmarrjeje që është fond investimesh ombrellë me pjesëmarrje të hapur ose me intervale me dy ose më shumë nënfonde, duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - a) Që mbajtësi i kuotave ka të drejtë të shkëmbejë kuotat e një nënfondi me kuotat e një nënfondi tjetër (përveç nënfondit që e ka të kufizuar emetimin e kuotave);
 - b) Se shkëmbimi i kuotave të një nënfondi me kuota të një nënfondi tjetër trajtohet si shlyerje dhe shitje, dhe për personat që i nënshtrohen regjimit tatimor shqiptar kjo konsiderohet si transaksion për qëllime të tatimit;
 - c) Që në asnjë rrethanë mbajtësi i kuotave që shkëmben kuotat e një nënfondi me kuota e një nënfond tjetër, nuk ka të drejtë ligjore për t'u tërhequr ose për të anuluar transaksionin;
 - d) Politikat për shpërndarjen ndërmjet nënfondeve të aktiveve ose kostove, tarifave dhe shpenzimeve të pagueshme nga pronësia e sipërmarrjes që nuk i atribuohen ndonjë nënfondi të veçantë;
 - e) Cilat janë tarifat e shkëmbimit, nëse ka, të kuotave të një nënfondi me kuotat e një nënfondi tjetër;
 - f) Monedha e vlerësimit të aktiveve të secilit nënfond të sipërmarrjes dhe çmimi i kuotave të llogaritura dhe pagesat e bëra, nëse kjo monedhë nuk është monedha bazë e sipërmarrjes që është sipërmarrje ombrellë.

Neni 26

Sipërmarrjet në investime kolektive ose nënfondet furnizuese

1. Në rastin e sipërmarrjeve ose nënfondeve furnizuese të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - a) Një deklaratë që sipërmarrja e investimeve kolektive ose nënfondi furnizues është një furnizues i një sipërmarrje të investimeve kolektive ose një nënfondi kryesor të veçantë

- dhe si i tillë investon përherë të paktën 85% të vlerës së aktiveve të sipërmarrjes në aksione ose kuota të kësaj sipërmarrje kolektive ose nënfondi kryesor;
- b) Objektivin dhe politikat e investimit, duke përfshirë profilin e riskut; dhe nëse të dhënat e performancës së sipërmarrjes së investimeve kolektive furnizuese dhe asaj kryesore janë identike, ose deri në çfarë mase dhe për cilat arsye ato ndryshojnë, duke përfshirë një përshkrim se si është investuar bilanci i aktiveve të sipërmarrjes që nuk është investuar në sipërmarrjen e investimeve kolektive kryesore;
 - c) Një përshkrim të shkurtër të sipërmarrjes të investimeve kolektive ose të nënfondit kryesor: organizimin e tij, objektivin dhe politikat e tij të investimit, duke përfshirë profilin e riskut dhe të dhëna se ku mund të merret prospekti i sipërmarrjes të investimit kolektiv ose nënfondit kryesor;
 - d) Një përmbledhje të marrëveshjes furnizuese ose nëse është e zbatueshme rregullat e brendshme të biznesit;
 - e) Mënyrën se si mbajtësit e kuotave mund të marrin informacion të mëtejshëm mbi sipërmarrjen e investimeve kolektive ose nënfondin kryesor dhe mbi marrëveshjen furnizuese;
 - f) Një përshkrim të të gjitha shpërblimeve ose rimbursimeve të kostove që duhet të paguhet nga sipërmarrja e investimeve kolektive ose nënfondi furnizues, në sajë të investimit të tij në kuota të sipërmarrjes së investimit kolektiv ose të nënfondit kryesor, si dhe pagesat agregate të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondi furnizues dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive ose nënfondit kryesor; dhe
 - g) Një përshkrim të implikimeve tatimore (nëse ka) të investimit në sipërmarrjen e investimeve kolektive ose nënfondit kryesor për sa i përket sipërmarrjes ose nënfondit furnizues.

Neni 27

Marketimi në një vend tjetër

1. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive të licencuar me pjesëmarrje të hapur ose me intervale, i cili përgatitet për qëllime të marketimit të kuotave në një vend tjetër përveç Shqipërisë, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - a) Rregullat dhe strukturimet që përdoren:
 - i. Në lidhje me pagesat në këtë vend të shumës që u shpërndahet mbajtësit të kuotave rezident në këtë vend;
 - ii. Në lidhje me shlyerjen në këtë vend të kuotave, të mbajtësve të kuotave rezident të këtij vendi;
 - iii. Në lidhje me inspektimin dhe vënien në dispozicion në vendin tjetër ku do të marketohen kuotat, të dokumentit themelues të sipërmarrjes dhe ndryshimet e tij, të prospektit SIK, si dhe raportit dhe pasqyrave financiare vjetore dhe të ndërmjetme;
 - iv. Për të bërë publike çmimin e kuotave të secilës klasë.

- b) Si publikohen njoftimet nga shoqëria administruese e fondit në këtë vend duke përcaktuar:
- i. Që raporti dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme janë të disponueshme për inspektim;
 - ii. Që është deklaruar shpërndarja e të ardhurave;
 - iii. Informacionin mbi ndërprerjen ose revokimin e licencës së sipërmarrjes.

Neni 28

Informacione shtesë

1. Informacion shtesë konsiderohet çdo informacion tjetër i rëndësishëm që personat kyç ose shoqëria administruese e fondeve janë në dijeni ose duhet të ishin në dijeni për shkak të kryerjes së funksionit, informacion i cili nëse do të vihej në dispozicion të investitorëve do të ndikonte në vendimarrje, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në fond, përfshirë por jo vetëm, të dhënat e mëposhtme:
- a) Informacion që investitorët dhe këshilltarët e tyre do të kërkonin në mënyrë të arsyeshme dhe që në mënyrë të arsyeshme supozohen të gjenden në prospektin SIK, me qëllim të marrjes së një gjykimi të informuar për investimin në sipërmarrjen ose nënfondin e licencuar, si dhe mbi shkallën dhe karakteristikat e rreziqeve që merren përsipër me pranimin e pjesëmarrjes në këtë investim;
 - b) Një shpjegim të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për çdo risk që paraqet investimi në sipërmarrjen ose nënfondin e licencuar për një investitor të kujdesshëm në mënyrë të arsyeshme;
 - c) Nëse ka ndonjë marrëveshje që synon kthime specifike nga investimi nga zotërimi i kuotave në sipërmarrjen ose nënfondin e licencuar ose objektiva investimi që ofrojnë mbrojtje të vlerës së kapitalit ose rikthimit të të ardhurave nga zotërimi i kuotave:
 - i. Detaje të kësaj marrëveshje ose mbrojtjes së sipërpërmendur;
 - ii. Përshkrim të rreziqeve që mund të ndikojnë në arritjen e këtij kthimi ose mbrojtjeje;
 - d) Nëse është dhënë njoftim për aksionarët ose mbajtësit e kuotave mbi synimin e shoqërisë administruese të fondit për të propozuar një ndryshim në sipërmarrjen ose nënfondin dhe nëse po, veçoritë e tij.

Neni 29

Dhënia e informacionit mbi transaksionet e financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*)

1. Informacioni që jepet në prospektin SIK të sipërmarrjes dhe në dhënien e informacioneve shpjeguese investitorëve përfshin sa më poshtë:
 - a) Përshkrimi i përgjithshëm i transaksioneve të financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*) të përdorura nga sipërmarrja e investimeve kolektive dhe arsyetimi për përdorimin e tyre;
 - b) Të dhënat e përgjithshme që duhet të raportohen për secilin lloj të transaksioneve të financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*);
 - c) Llojet e aktiveve që mund t'u nënshtrohen atyre;
 - d) Përqindja maksimale e aktiveve nën administrim të sipërmarrjes ose nënfondit që mund t'u nënshtrohet atyre;
 - e) Pjesa e pritur e aktiveve nën administrim të sipërmarrjes ose nënfondit që u nënshtrohet secilit prej tyre;
 - f) Kriteret e përdorura për të zgjedhur palët e treta (duke përfshirë statusin ligjor, vendin e origjinës, vlerësimin minimal të kreditit);
 - g) Kolateral i pranueshëm: përshkrimi i kolateralit të pranueshëm në lidhje me llojet e aktiveve, emetuesit, maturinë, likuiditetin, si dhe politikat e diversifikimit dhe korrelacionit të kolateralit;
 - h) Vlerësimi i kolateralit: përshkrimi i metodologjisë së vlerësimit të kolateralit që përdoret dhe arsyetimi i saj, dhe nëse përdoren marzhet e përditshme të vlerësimit më të fundit në treg dhe të variacioneve ditore;
 - i) Menaxhimi i riskut: përshkrimi i rreziqeve që lidhen me transaksionet e financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*), si dhe rreziqet që lidhen me menaxhimin e kolateralit, me funksionimin, likuiditetin, me palën e tretë, me kujdestarinë dhe rreziqet ligjore dhe, aty ku është e mundur, rreziqet që rrjedhin nga ripërdorimi i tij;
 - j) Specifikimin se si ruhen aktivet që i nënshtrohen transaksioneve të financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*) dhe kolaterali i pranuar (për shembull te depozitari);
 - k) Specifikimin e çdo kufizimi (rregullator ose vetë imponues) për ripërdorimin e kolateralit;
 - l) Politika mbi shpërndarjen e kthimit të krijuar nga transaksionet e financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*): përshkrimi i përqindjeve të ardhurave të krijuara nga transaksionet e financimit të titujve dhe marrëveshjet e shkëmbimit të bazuara mbi kthimin (*total return swaps*) që i kthehen sipërmarrjes ose nënfondit të investimeve kolektive dhe shpenzimet dhe tarifatat që i tarifohen shoqërisë administruese së fondeve ose palëve të treta (si p.sh. nga huadhënësi i agjentit);

2. Prospekti SIK ose informacioni që u jepet investitorëve specifikon gjithashtu nëse këto janë subjekte të lidhura ose subjekte me lidhje të pronësisë me shoqërinë administruese të fondit.

Neni 30

Vënia në dispozicion e prospektit SIK

1. Prospekti i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin u vihen në dispozicion pa pagesë investitorëve të mundshëm përpara lidhjes së një kontrate për blerjen e pjesëmarrjeve.
2. Në rastin e sipërmarrjes furnizuese, prospekti i sipërmarrjes kryesore, ku investon sipërmarrja furnizuese dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin u vihen në dispozicion pa pagesë sipas kërkesës.

KREU IV

DOKUMENTI I INFORMACIONIT KRYESOR PËR INVESTITORËT

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 31

Dispozita të përgjithshme

1. Dispozitat e këtij Kreu specifikojnë formën dhe përmbajtjen e dokumentit që përmban informacionin kryesor të investitorëve të kërkuar sipas nenit 93 të ligjit dhe Shtojcës 1 të kësaj rregullore.
2. Asnjë informacion apo deklaratë (specifikim) tjetër nuk do të përfshihet në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

SEKSIONI II
FORMATI DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË INFORMACIONIT
KRYESOR PËR INVESTITORËT

Neni 32

Formati dhe përmbajtja e përgjithshme e dokumentit të informacionit kryesor për investitorët

1. Përmbajtja e dokumentit të informacionit kryesor për investitorët duhet të paraqitet sipas rendit të përcaktuar në këtë rregullore dhe sipas strukturës të përcaktuar në Shtojcën 1 të kësaj rregullore.
2. Titulli "Informacioni kryesor i investitorëve" duhet të shfaqet dukshëm në krye të faqes së parë të dokumentit të informacionit kryesor për investitorët.
3. Poshtë titullit jepet një deklaratë, ku thuhet: "Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo."
4. Identifikimi i sipërmarrjes së investimeve kolektive, duke përfshirë klasën e kuotës ose nënfondin e saj, duhet të theksohet në mënyrë të dukshme. Në rastin e një nënfondi ose të një klase kuote, emri i sipërmarrjes duhet të ndjekë nënfondin ose emrin e klasës së kuotës. Nëse ekziston një kod ose numër licence që identifikon sipërmarrjen e investimeve kolektive, nënfondin ose klasën e kuotës, atëherë kjo do të jetë pjesë e identifikimit të sipërmarrjes së investimeve kolektive.
5. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët me titull "Objektivat dhe politika e investimeve" përmban informacionin e përcaktuar në nenin 33 të kësaj rregulloreje.
6. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët me titull "Profili i riskut dhe përfitimit" përmban informacionin e përcaktuar në nenin 34 të kësaj rregulloreje.
7. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët me titull "Tarifat" përmban informacionin e përcaktuar në nenin 36 të kësaj rregulloreje.
8. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët me titull "Performanca e kaluar" përmban informacionin e përcaktuar në nenin 40 të kësaj rregulloreje.

9. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët me titull "Informacione praktike" përmban informacionin e përcaktuar në nenin 43 të kësaj rregulloreje.
10. Detajet e licencimit përbëhen nga deklarata e mëposhtme: "Kjo sipërmarrje e investimeve kolektive është e licencuar dhe rregullohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Republikën e Shqipërisë .

Neni 33

Karakteristikat specifike të përshkrimit të objektivave dhe politikës së investimeve

1. Përshkrimi i dhënë në seksionin "Objektivat dhe politikat e investimit" të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit mbulon ato tipare thelbësore të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose fondit për të cilin investitori duhet të informohet, edhe nëse këto karakteristika nuk janë pjesë e përshkrimit të objektivave dhe politikës së investimeve në prospektin SIK, duke përfshirë:
 - a) Kategoritë kryesore të instrumenteve financiarë që janë objekt i investimit;
 - b) Aty ku është e mundur, përcaktimi që investitori mund të shlyejë/shesë kuota të SIK ose të nënfondit sipas kërkesës së tij dhe përcaktimi sa shpesh mund ta bëjë këtë;
 - c) Përcaktimin nëse sipërmarrja ose nënfondi kanë një objektiv të caktuar në lidhje me sektorët e industrisë, terrenin gjeografik apo sektorë të tjerë të tregut ose klasa specifike të aktiveve;
 - d) Përcaktimin nëse sipërmarrja ose nënfondi lejojnë zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme, dhe nëse kjo qasje përfshin apo i referohet një standardi referues (*benchmark*) dhe nëse po cili është ky;
 - e) Nëse të ardhurat shpërndahen apo rinvestohen;
2. Për qëllimet e shkronjës d, të pikës 1 të këtij neni, në rastin e referimit të një standardi referues, duhet të përfshihet shkalla e lirisë në dispozicion në lidhje me këtë pikë referimi dhe duhet të specifikohet nëse sipërmarrja ka një objektiv të gjurmimit të indeksit.
3. Përshkrimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni përfshin informacionin e mëposhtëm, për sa kohë që është e përshtatshme:
 - a) Nëse sipërmarrja ose nënfondi investon në letrat me vlerë të borxhit, duhet të tregohet nëse ato janë emetuar nga shoqëritë, qeveritë apo subjekte të tjera dhe nëse është e zbatueshme, çdo kërkesë minimale për klasifikimin/vlerësim (*rating*) e këtyre letrave me vlerë të borxhit;
 - b) Nëse zgjedhja e aktiveve udhëhiqet nga strategji specifike, një shpjegim i strategjive të investimit , të tilla si "rritja", "vlera" ose "dividentët e lartë";
 - c) Nëse përdoren teknika të veçanta të menaxhimit të portofolit, të cilat mund të përfshijnë mbrojtje (*hedging*), një shpjegim në terma të thjeshtë të faktorëve që pritet të përcaktojnë performancën e sipërmarrjes;

- d) Nëse ndikimi i kostove të transaksionit të portofolit mbi kthimet ka të ngjarë të jetë i konsiderueshëm për shkak të strategjisë së miratuar nga sipërmarrja ose nënfondi, duke pohuar ekzistencën e këtij rasti dhe duke e bërë gjithashtu të qartë që kostot e transaksionit të portofolit paguhen nga aktivet e sipërmarrjes ose nënfondit përveç detyrimeve të përcaktuara në nenet 36, 37 dhe 38 të kësaj rregulloreje;
 - e) Nëse në prospektin SIK ose në ndonjë reklamë është specifikuar një afat minimal i rekomanduar për mbajtjen e aksioneve/kuotave në sipërmarrjen ose nënfondin, duhet të përfshihet një deklaram me formulimin e mëposhtëm: “Rekomandim: kjo [sipërmarrje ose nënfond] mund të mos jetë e përshtatshme për investitorët të cilët planifikojnë të shlyejnë kuotat e tyre brenda [periudhës kohore]”.
4. Seksioni “Objektivat dhe politikat e investimit”, te dokumenti i informacionit kryesor për investitorët mund të përmbajë elemente të tjerë përveç atyre të renditura në pikën 3 të këtij neni, duke përfshirë përshkrimin e strategjisë investuese të sipërmarrjes ose të nënfondeve, nëse këto elementë janë të nevojshëm për të përshkruar në mënyrë të përshtatshme objektivat dhe politikat e investimit të sipërmarrjes ose të nënfondit.

Neni 34

Profili i riskut dhe përfitimi nga investimi

1. Seksioni i dokumentit të informacionit kryesor për investitorin, i titulluar “Profili i riskut dhe përfitimit” përmban një tregues sintetik, të plotësuar me:
 - a) Një shpjegim narrativ të treguesit dhe kufizimet e tij kryesore;
 - b) Një shpjegim narrativ i rreziqeve që janë thelbësore për sipërmarrjen dhe të cilat nuk janë kapur në mënyrë të përshtatshme nga treguesi sintetik.
2. Treguesi sintetik i përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të marrë formën e një serie kategorish në një shkallë numerike, ku sipërmarrja e caktuar kategorizohet në njërin nga këto shkallë numerike. Paraqitja e treguesit sintetik duhet të jetë në përputhje me kërkesat e parashtruara në seksionin 1.B të Shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.
3. Llogaritja e treguesit sintetik të përmendur në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo rishikim i mëvonshëm i tij, duhet të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme.
4. Shoqëritë administruese të fondit ruajnë të dhënat e këtyre llogaritjeve sipas periudhave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, por për një periudhë jo më pak se pesë vjet.
5. Përshkrimi narrativ i përmendur në pikën 1, shkronja a) të këtij neni përfshin informacionin e mëposhtëm:
 - a) Një deklaratë se të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna të besueshme për profilin e ardhshëm të riskut të SIK;

- b) Një deklaratë se kategoria e treguar e riskut dhe e përfitimit nuk garantohet se do të mbetet e pandryshuar dhe se kategoria e riskut me kalimin e kohës mund të ndryshojë;
 - c) Një deklaratë se kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk;
 - d) Një shpjegim i shkurtër se përse SIK është në kategorinë përkatëse;
 - e) Detaje për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje të ofruar nga SIK për kapitalin e investitorit, duke përfshirë këtu efektet e mundshme për shlyerjen e kuotave jashtë periudhës së garantuar ose të mbrojtur.
6. Përshkrimi narrativ i përmendur në pikën 1, shkronja b) të këtij neni përfshin informacionin e mëposhtëm, nëse këto janë të rëndësishme:
- a) Risku i kreditit, kjo në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në titujt e borxhit;
 - b) Risku i likuiditetit, kjo në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në instrumente financiare, të cilat prej natyrës, në rrethana të caktuara, mund të kenë një nivel të ulët likuiditeti, aq sa mund të kenë një ndikim mbi nivelin e riskut të likuiditetit të sipërmarrjes në tërësi;
 - c) Risku i palës tjetër, kur sipërmarrja ka ekspozim të një niveli të konsiderueshëm si rezultat i kontratave me një palë tjetër;
 - d) Risku operacional që rezulton nga ruajtja e aktiveve;
 - e) Ndikimi i teknikave financiare mbi profilin e riskut të sipërmarrjes ose nënfondit, siç mund të jenë kontratat derivative, kur këto teknika përdoren për të arritur, rritur apo zvogëluar ekspozimin e aktiveve.

Neni 35

Parimet që rregullojnë identifikimin, shpjegimin dhe paraqitjen e rreziqeve

Identifikimi dhe shpjegimi i rreziqeve të referuara në nenin 34 të kësaj rregulloreje duhet të jenë në përputhje me procesin e brendshëm për identifikimin, matjen dhe monitorimin e riskut të miratuar nga shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit, siç përcaktohet në Ligj. Nëse shoqëria administruese e fondeve administron më shumë se një sipërmarrje, rreziqet duhet të identifikohen dhe shpjegohen në mënyrë të qëndrueshme.

Neni 36

Paraqitja e kostove dhe tarifave

1. Seksioni “Komisionet dhe tarifat e SIK” në dokumentin e informacionit kryesor për investitorin duhet të përmbajë paraqitjen e kostove dhe tarifave në formën e një tablele siç përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

2. Tabela e referuar në pikën 1 të këtij neni duhet të plotësohet në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - a) Komisionet e hyrjes dhe daljes shprehen në përqindjen maksimale të tyre që duhet të paguhet nga investitori për llogari të sipërmarrjes para investimit dhe para daljes nga SIK;
 - b) Një shifër e vetme duhet të përfshihet për pagesat e marra nga sipërmarrja ose nënfondi gjatë një viti, që do të njihen si "tarifa të vazhdueshme", që përfaqësojnë të gjitha tarifat vjetore dhe pagesat e tjera të marra nga aktivet e sipërmarrjes ose të nënfondit gjatë periudhës së caktuar, si dhe bazuar në shifrat për vitin paraprak llogaritur sipas kërkesave të Shtojcës 1 të kësaj rregulloreje;
 - c) Tabela rendit dhe shpjegon çdo kosto që i ngarkohet aktiveve të SIK ose të nënfondit sipas kushteve të caktuara specifike, bazën mbi të cilën llogariten kostot dhe kur zbatohen ato.

Neni 37

Shpjegimi i tarifave dhe specifikimi i rëndësisë së tyre

1. Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Komisionet dhe tarifat e SIK”, duhet të përmbajë fillimisht një deklaratë rreth rëndësisë së komisioneve dhe tarifave, të cilat përdoren për të paguar kostot e administrimit të SIK, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave/aksioneve të SIK. Deklarata duhet të cilësojë se komisionet dhe tarifat që kryhen zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.
2. Për secilën nga komisionet apo tarifat e specifikuar në tabelë duhet të jepet një shpjegim me fjalë, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
 - a) Në lidhje me “komisionet apo tarifat e hyrjes dhe daljes” duhet të bëhet e qartë se shifrat e paraqitura janë shifra maksimale, pasi në disa raste investitori mund të paguajë më pak, për këtë fakt investitori mund të informohet nga këshilltari i tij i investimit;
 - b) Në lidhje me “komisionet apo tarifat vjetore të vazhdueshme”, duhet të bëhet një deklaratë se kjo shifër bazohet në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen tarifa e performancës dhe/ose kostot e transaksioneve të portofolit, duke përjashtuar rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK, të tjera.
3. Seksioni për komisionet apo tarifat duhet të japë referencën për ato pjesë të prospektit të SIK, ku jepet informacioni më i detajuar rreth komisioneve apo tarifave.

Neni 38

Raste specifike

1. Nëse sipërmarrja ose nënfondi i ri nuk mund të përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 36 dhe nenin 37 të kësaj rregulloreje, pagesat e vazhdueshme vlerësohen në bazë të totalit të pritshëm të detyrimeve siç përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastet e mëposhtme:
 - a) Kur sipërmarrja ose nënfondi specifikon një tarifë fikse gjithëpërfshirëse;
 - b) Kur sipërmarrja ose nënfondi vendos një tavan ose maksimum të shumës që mund të tarifohet, në këtë rast kjo shifër do të specifikohet për sa kohë që shoqëria administruese e fondit angazhohet të zbatojë shifrën e publikuar dhe të marrë përsipër çdo kosto që do të shkaktonte tejkallim të shifrës.

Neni 39

Kërkesa shtesë

1. Të gjithë elementët e strukturës së tarifave paraqiten sa më qartë që të jetë e mundur për të lejuar investitorët të marrin në konsideratë kostot dhe tarifat totale.
2. Nëse ndikimi i kostove të transaksionit të portofolit mbi kthimet është i konsiderueshëm për shkak të strategjisë së miratuar nga sipërmarrja ose nënfondi, kjo duhet të specifikohet brenda seksionit "Objektivat dhe politikat e investimit", siç përcaktohet në nenin 33 të kësaj rregulloreje.

Neni 40

Paraqitja e performancës së kaluar

1. Informacioni për performancën e kaluar të sipërmarrjes ose të nënfondit duhet të paraqitet në një grafik me kolona që mbulon performancën e sipërmarrjes ose të nënfondit për 10 vitet e fundit. Madhësia e grafikut duhet të jetë e lexueshme, por në asnjë rrethanë nuk duhet të jetë më shumë se gjysmë faqe e formatit A-4 të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit.
2. Sipërmarrjet ose nënfondet me performancë më të vogël se 5 vite kalendarike të plota, përdorin një grafik që mbulon vetëm 5 vitet e fundit.
3. Për çdo vit për të cilin të dhënat nuk janë në dispozicion, viti do të tregohet bosh pa asnjë shënim tjetër përveç datës.
4. Për sipërmarrjen ose fondin që nuk ka ende të dhëna të performancës për një vit të plotë kalendarik, përfshihet një specifikim që shpjegon se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të dhënë një tregues të dobishëm të performancës së kaluar për investitorët.

5. Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë të vitit aktual kalendarik, duke e konsideruar si performancë e kaluar.
6. Përlllogaritja e shifrave të performancës së kaluar duhet të bazohet në vlerën neto të aseteve të SIK, dhe duhet të mbahet parasysh nëse të ardhurat nga investimi i aseteve të SIK janë riinvestuar.
7. Grafiku duhet të shoqërohet me një deklaratë, ku të shfaqen dukshëm:
 - a) Paralajmërimi për vlerën e kufizuar që ai ka si udhërrëfyes për performancën e ardhshme;
 - b) Paraqitja shkurtimisht e tarifave dhe pagesave që janë përfshirë apo përjashtuar në përlllogaritjen e performancës së kaluar;
 - c) Paraqitja e vitit në të cilin fondi ka nisur veprimtarinë;
 - d) Paraqitja e monedhës në të cilën është përlllogaritur performanca e kaluar. Kërkesa e parashtruar në shkronjën b) të kësaj pike nuk zbatohet për sipërmarrjen ose nënfondin që nuk ka tarifa hyrëse ose dalëse.
 - e) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë të vitit aktual kalendarik, duke e konsideruar si performancë e kaluar.
8. Grafiku duhet të jetë në përputhje me kriteret e mëposhtme:
 - a) Shkalla e boshtit Y duhet të jetë lineare, jo logaritmike;
 - b) Shkalla duhet të përshtatet me hapësirën e kolonave të specifikuar dhe nuk duhet të zvogëlojë kolonat në mënyrë që vështirësojë dallimin e luhatjeve të kthimeve;
 - c) Boshti X duhet të vendoset në nivelin e performancës 0%;
 - d) Në secilën kolonë përfshihet një etiketim që tregon kthimin në përqindje që është arritur;
 - e) Shifrat e kaluara të performancës duhet të rrumbullakosen në shifra dhjetore.
9. Në rastin e një ndryshimi në objektivat dhe politikën e investimit me efekt material gjatë periudhës së paraqitur në grafik, performanca e kaluar e SIK vazhdon të pasqyrohet para këtij ndryshimi material. Periudha para ndryshimit me efekt material duhet të tregohet në grafik dhe të etiketohet me një paralajmërim të qartë se kjo performancë është arritur në rrethana që nuk aplikohen më.

Neni 41

Përdorimi i standardit referues (*benchmark*) krahas performancës së kaluar

1. Nëse seksioni "Objektivat dhe politikat e investimit" të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit i referohet një standardi referues, atëherë në grafik duhet të përfshihet një kolonë

që tregon performancën e atij standardi, së bashku me çdo kolonë që tregon performancën e kaluar të sipërmarrjes.

2. Për sipërmarrjet ose nënfondet të cilat nuk kanë të dhëna të kaluara të performancës të pesë apo 10 viteve të kërkuara, standardi referues nuk duhet të tregohet për vitet në të cilat sipërmarrja ose nënfondi nuk ka ekzistuar.

Neni 42

Përdorimi i të dhënave simuluese të performancës së kaluar

1. Përdorimi i të dhënave simuluese të performancës për periudhën për të cilën nuk ka të dhëna përkatëse, lejohet vetëm në rastet e mëposhtme, me kusht që përdorimi të jetë i drejtë, i qartë dhe jo çorientues:
 - a) Një klasë e re kuote të sipërmarrjes ose nënfondit ekzistues mund të simulojë performancën e saj duke marrë parasysh performancën e një klase tjetër, me kusht që këto dy klasa të mos ndryshojnë thelbësisht për sa i përket shtrirjes së pjesëmarrjes së tyre në aktivet e sipërmarrjes ose të nënfondit;
 - b) Sipërmarrja ose nënfondi furnizues mund të simulojë performancën e tij duke marrë parasysh performancën e sipërmarrjes ose nënfondit të saj kryesor, me kusht që të plotësohen një nga kushtet e mëposhtme:
 - i. Strategjia dhe objektivat e sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues nuk e lejojnë atë të mbajë aktive të tjera, përveç kuotave të sipërmarrjes ose të nënfondit kryesor dhe aktiveve likuide;
 - ii. Karakteristikat e sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato të sipërmarrjes ose të nënfondit kryesor.
2. Në rastet që performanca është e simuluar sipas pikës 1 të këtij neni, në grafik duhet të specifikohet dukshëm që performanca është simuluar.
3. Në rastin e bashkimeve, në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit përfshihet vetëm performanca e kaluar e sipërmarrjes ose nënfondit marrës.

Neni 43

Përmbajtja e seksionit “Informacione praktike”

1. Seksioni “Informacioni praktik” i dokumentit të informacionit kryesor për investitorët përmban informacionin e mëposhtëm që i nevojitet investitorit në çdo vend ku tregton sipërmarrja në fjalë:
 - a) Emrin e depozitarit;

- b) Ku dhe si mund të sigurohen informacione të mëtejshme për sipërmarrjen ose nënfondin, kopjet e prospektit SIK dhe raportet dhe pasqyrat më të fundit vjetore, si dhe çdo raport dhe pasqyra financiare të mëvonshme të ndërmjetme, duke treguar në cilën gjuhë këto dokumente janë të disponueshme dhe duke specifikuar se këto informacione dhe dokumente janë falas;
 - c) Ku dhe si mund të sigurohen informacione të tjera praktike, duke përfshirë çmimet më të fundit të aksioneve ose kuotave;
 - d) Deklaratë që legjislacioni tatimor i vendit të origjinës së sipërmarrjes ose nënfondit mund të ketë ndikim në pozitën tatimore personale të investitorit;
 - e) Deklaratën e mëposhtme: “*[Të shtohet emri i shoqërisë së investimit/shoqërisë administruese të fondit ose shoqërisë administruese të fondit]* është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit SIK të sipërmarrjes.”
 - f) Nëse dokumenti i informacionit kryesor të investitorit është përgatitur për një nënfond, seksioni "Informacioni praktik" përfshin informacionin e specifikuar në nenin 48 të kësaj rregulloreje duke specifikuar të drejtat transferuese të investitorëve për të kaluar nga një nënfond në një tjetër.
2. Nëse është e aplikueshme, seksioni “Informacioni praktik” i dokumentit të informacionit kryesor të investitorit përmban informacionin e kërkuar për aksionet ose klasat e kuotave të disponueshme në përputhje me nenin 49 të kësaj rregulloreje.

Neni 44

Përdorimi i referencave

1. Referencat e përdorura në dokumentin e informacionit kryesor për investitorin, duke përfshirë prospektin SIK, si dhe raportet dhe pasqyrat financiare të vjetore ose të ndërmjetme, mund të përfshihen me kusht që të gjitha këto informacione kryesore ndihmojnë investitorin të kuptojë elementet thelbësore të investimit. Lejohen referencat me faqen e internetit të sipërmarrjes ose të nënfondit ose të shoqërisë administruese të fondit, apo edhe pjesë të këtyre faqeve të internetit që përmbajnë prospektin SIK, si dhe raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme.
2. Referencat të përmendura në pikën 1 të këtij neni e drejtojnë investitorin në seksionin e veçantë të burimit përkatës të informacionit. Brenda dokumentit të informacionit kryesor të investitorëve mund të përdoren referenca të ndryshme, por ato duhet të jenë sa më pak që të jetë e mundur.

Neni 45
Rishikimi i informacionit kryesor për investitorin

1. Shoqëria administruese kryen rishikimin e dokumentit me informacionin kryesor për investitorin të paktën çdo dymbëdhjetë muaj.
2. Rishikimi i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin kryhet para çdo ndryshimi të propozuar të prospektit SIK dhe të rregullave të SIK.
3. Rishikimi duhet të kryhet përpara ose gjatë çdo ndryshimi që konsiderohet me efekt material për informacionin që përmban dokumenti me informacionin kryesor për investitorin.

Neni 46
Publikimi i dokumentit të rishikuar

1. Në rastin e rishikimit sipas përcaktimeve të nenit 45 të kësaj rregulloreje, dokumenti i rishikuar u vihet menjëherë në dispozicion investitorëve.
2. Nëse ndryshimi në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit vjen si rezultat i pritur i një vendimi të shoqërisë administruese të fondit, duke përfshirë ndryshimet në prospektin SIK ose në dokumentin themelues të sipërmarrjes, dokumenti i rishikuar duhet të vihet në dispozicion të investitorit, përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi.
3. Dokumenti i rishikuar, si rezultat i korigjimit të seksionit mbi performancën e kaluar të SIK, duhet të vihet në dispozicion të investitorit, jo më vonë se 35 ditë pune, pas datës 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 47
Ndryshime të rëndësishme në strukturën e tarifimit

1. Informacioni mbi tarifën pasqyron siç duhet çdo ndryshim në strukturën e tarifimit të çdo tarife të pagueshme vetëm njëherë drejtpërdrejt nga investitori, që ndikon në një rritje të shumës maksimale të lejuar.
2. Kur "tarifat e vazhdueshme" të llogaritura në përputhje me nenin 36 të kësaj rregulloreje nuk janë më të besueshme, shoqëria administruese e fondeve llogarit një shifër për "tarifat e vazhdueshme" që parashikon në mënyrë të arsyeshme të jetë shuma që do të tarifohet në të ardhmen nga sipërmarrja. Ky ndryshim përfshihet në deklaratën e mëposhtme: Shifra e "tarifave të vazhdueshme" e paraqitur këtu është një vlerësim i përafërt i pagesave. [Shëno

përshkrimin e shkurtër të arsyes se pse është duke u përdorur një vlerësim i përafërt dhe jo shifër e bazuar mbi fakte].

3. Raporti vjetor i sipërmarrjes për çdo vit financiar përfshin detaje mbi tarifën e paguar.

Neni 48 Nënfondet

1. Kur sipërmarrja përbëhet nga dy ose më shumë nënfonde, përgatitet një dokument i veçantë i informacionit për investitorët për secilin nënfond individual.
2. Secili dokument i informacionit kryesor për investitorin i referuar në pikën 1 të këtij neni përmban në seksionin "informacione praktike" informacionin e mëposhtëm:
 - a) Se dokumenti i informacionit kryesor për investitorin përshkruan një nënfond të një sipërmarrjeje por, prospekti SIK, raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe ato të ndërmjetme janë përgatitur për të gjithë sipërmarrjen;
 - b) Se aktivet dhe pasivet e secilit nënfond janë të veçuara sipas parashikimeve të ligjit dhe se si kjo mund të ndikojë tek investitori;
 - c) Nëse investitori ka të drejtë të shkëmbejë investimet e tij në kuota nga një nënfond me kuota në një tjetër nënfond, dhe nëse po, ku mund të marrë informacione se si do të ushtrohet kjo e drejtë.
3. Nëse shoqëria administruese e fondit e tarifon investitorin për shkëmbimin e investimit të tij në përputhje me pikën 2, shkronja c) të këtij neni dhe nëse kjo pagesë ndryshon nga pagesa standarde për blerjen ose shitjen e kuotave, kjo pagesë duhet të specifikohet veçmas në seksionin "Tarifat" të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit.

Neni 49 Rastet kur SIK ka më shumë se një klasë aksionesh ose kuotash

1. Nëse sipërmarrja përbëhet nga dy ose më shumë klasa aksionesh ose kuotash, dokumenti i informacionit kryesor për investitorin përgatitet për çdo klasë të aksioneve ose kuotave.
2. Dokumenti i informacionit kryesor të investitorëve që lidhet me dy ose më shumë klasa të së njëjtës sipërmarrje ose nënfondi mund të shkrihet në një dokument të vetëm të informacionit të investitorit, me kusht që dokumenti përfundimtar të jetë plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 32 të kësaj rregulloreje duke përfshirë gjithashtu edhe specifikimet e gjatësisë së dokumentit.

3. Shoqëria administruese e fondeve zgjedh një klasë për të përfaqësuar një ose më shumë klasa të tjera të sipërmarrjes ose të nënfondit, me kusht që zgjedhja të jetë e drejtë, e qartë dhe jo çorientuese për investitorët potencialë të këtyre klasave të tjera. Në raste të tilla, seksioni "Profili i rrezikut dhe shpërblimit" i dokumentit të informacionit kryesor të investitorit përmban shpjegimin e rrezikut thelbësor të zbatueshëm për cilëndo nga klasat e tjera që përfaqësohen. Dokumenti i informacionit kryesor për investitorët bazuar në klasën përfaqësuese mund t'i ofrohet investitorëve të klasave të tjera.
4. Klasat e ndryshme nuk duhet të kombinohen në një klasë përfaqësuese të përbërë siç referohet në pikën 3 të këtij neni.
5. Shoqëria administruese e fondeve mban një regjistër të klasave të tjera që përfaqësohen nga klasa përfaqësuese e përmendur në pikën 3 të këtij neni dhe arsyet që justifikojnë këtë zgjedhje.

Neni 50

Seksioni i informacionit praktik mbi klasat e aksioneve ose kuotave

1. Nëse është e zbatueshme, seksioni "Informacioni praktik" i dokumentit të informacionit kryesor të investitorit plotësohet me specifikimin se cila klasë është zgjedhur si përfaqësuese, duke specifikuar afatin me të cilin është përcaktuar në prospektin SIK.
2. Ky seksion specifikon gjithashtu vendin se ku investitorët mund të marrin informacion në lidhje me klasat e tjera të sipërmarrjeve që tregtohen në Shqipëri.

Neni 51

Seksioni i objektivave dhe politikës së investimeve të fondit të fondeve

Nëse sipërmarrja ose nënfondi është një fond fondesh sipas nenit 2, pika 22 e Ligjit, përshkrimi i objektivave dhe politikës investuese të kësaj sipërmarrjeje ose nënfondi në dokumentin e informacionit kryesor për investitorët përfshin gjithashtu një shpjegim të shkurtër se si përzgjidhen sipërmarrjet e tjera kolektive në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 52

Seksioni i profilit të riskut dhe përfitimit të fondit të fondeve

Shpjegimi narrativ i faktorëve të riskut i përmendur në nenin 34 në lidhje me fondin e fondeve merr parasysh rreziqet që paraqet secila sipërmarrje kolektive bazë, në atë masë që ato kanë të ngjarë të jenë të konsiderueshme për sipërmarrjen në tërësi.

Neni 53

Seksioni i tarifave i fondit të фонде

Përshkrimi i tarifave në lidhje me fondin e фонде merr parasysh çdo tarifë që i tarifohet këtij fondi si investitor në një sipërmarrje të investimeve kolektive ose nënfond. Në mënyrë më specifike, fondi i фонде pasqyron në llogaritjen e shifrës së kostove dhe tarifave të vazhdueshme të tij, çdo komision hyrës dhe dalës si dhe tarifën e vazhdueshme që i ngarkohen nga investimi në sipërmarrjen e investimeve kolektive ose nënfondin.

Neni 54

Seksioni objektivave dhe politikës së investimeve të fondit furnizues

1. Dokumenti i informacionit kryesor për investitorët të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues përmban në përshkrimin e objektivave dhe politikën e investimeve, informacionin mbi proporcionin e aktiveve të sipërmarrjes furnizuese që është investuar në sipërmarrjen kryesore.
2. Gjithashtu përfshihet një përshkrim i objektivave dhe politikës së investimeve të sipërmarrjes kryesore të plotësuara përkatësisht me informacionet e mëposhtme:
 - a) Deklarim se kthimet e investimeve të sipërmarrjes furnizuese do të jenë shumë të ngjashme me ato të sipërmarrjes kryesore; dhe/ose
 - b) Shpjegim se si dhe pse kthimet e investimeve të sipërmarrjes furnizuese dhe kryesore mund të ndryshojnë.

Neni 55

Seksioni i profilit të riskut dhe përfitimit të fondit furnizues

1. Nëse profili i riskut dhe i përfitimit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ndryshon në çdo aspekt thelbësor nga ai i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, atëherë në seksionin "Profili i riskut dhe përfitimit" të dokumentit të informacionit kryesor për investitorët duhet të shpjegohet ky fakt dhe arsyet përkatëse të tij.
2. Risku i likuiditetit, si dhe marrëdhënia e blerjes dhe shlyerjes të sipërmarrjes/nënfondit kryesor dhe furnizues, duhet të shpjegohen në seksionin "Profili i riskut dhe përfitimit" të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit.

Neni 56

Seksioni i tarifave i fondit furnizues

1. Seksioni "Tarifat" të dokumentit të informacionit kryesor të investitorëve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues mbulon kostot e investimit në sipërmarrjen ose nënfondin furnizues si dhe

çdo shpenzim dhe pagesë që sipërmarrja ose nënfondi kryesor mund t'i tarifojë sipërmarrjes ose nënfondit furnizues.

2. Përveç kësaj, ai përfshin kostot e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues dhe kryesor në shifrën e tarifave të vazhdueshme për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues.

Neni 57

Seksioni “Informacione praktike” të fondit furnizues

1. Dokumenti i informacionit kryesor për investitorët për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues përmban në seksionin "Informacione praktike", informacione specifike për sipërmarrjen furnizuese.
2. Informacioni i referuar në pikën 1 të këtij neni përfshin:
 - a) Specifikim që prospekti SIK, dokumenti i informacionit kryesor të investitorëve, si dhe raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, me kërkesë të investitorit mund t'i vihen në dispozicion atij, informacion se ku mund të gjenden këto dokumente dhe në çfarë gjuhe janë të disponueshme ato;
 - b) Nëse informacionet e përmendura në shkronjën a) të kësaj pike janë të disponueshme vetëm në formë të shtypur në letër apo edhe në mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi;
 - c) Specifikim që nëse sipërmarrja ose nënfondi kryesor është i vendosur në një vend tjetër të ndryshëm nga sipërmarrja furnizuese, kjo mund të ndikojë në trajtimin e taksave të furnizuesit.

Neni 58

Paraqitja e performancës së kaluar të fondit furnizues

1. Paraqitja e performancës së kaluar në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të jetë specifike për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues dhe nuk duhet të kopjojë raportin e performancës të sipërmarrjes ose të nënfondit kryesor.
2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastet e mëposhtme:
 - a) Nëse sipërmarrja ose nënfondi furnizues tregon performancën e kaluar të sipërmarrjes ose të nënfondit të saj kryesor si standard referues; ose
 - b) Nëse sipërmarrja furnizuese ka filluar veprimtarinë e saj si sipërmarrje ose nënfond furnizues në një datë më të vonshme se sipërmarrja ose nënfondi kryesor dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara sipas pikës 9 të nenit 40 të kësaj rregulloreje, si dhe nëse për vitet e para të ekzistencës së fondit furnizues paraqitet një performancë simuluese, bazuar në performancën e kaluar të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor; ose

- c) Nëse sipërmarrja ose nënfondi furnizues ka të dhëna të performancës së kaluar që para datës së fillimit të veprimtarisë si furnizues, të dhënat e tij pasqyrohen në tabelën me kolona për vitet përkatëse, me ndryshimet e rëndësishme të etiketuar siç përcaktohet në pikën 9 të nenit 40 të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI III

VËNIA NË DISPOZICION E DOKUMENTIT TË INFORMACIONIT KRYESOR PËR INVESTITORËT

Neni 59

Vënia në dispozicion e dokumentit të informacionit kryesor për investitorët

1. Vënia në dispozicion e dokumentit të informacionit kryesor për investitorët për SIK i sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike bëhet në përputhje me pikën 1 të neni 30 të kësaj rregulloreje.
2. Në rastin e sipërmarrjes furnizuese, dokumenti me informacionin kryesor për investitorin i sipërmarrjes kryesore, ku investon sipërmarrja furnizuese u vihen në dispozicion në përputhje me pikën 2 të neni 30 të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI IV

KUSHTET E ZBATUESHME PËR DHËNIEN E DOKUMENTIT TË INFORMACIONIT KRYESOR TË INVESTITORIT OSE TË PROSPEKTIT TË SIK

Neni 60

Kushtet e zbatueshme për dhënien e dokumentit të informacionit kryesor të investitorit ose të prospektit të SIK në një mjet të qëndrueshëm komunikimi, përveç letrës ose faqes së internetit

Në përputhje me pikën 16 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, dhënia e informacionit me anë të komunikimeve elektronike trajtohet si e përshtatshme në kontekstin e kryerjes së biznesit ndërmjet shoqërisë administruese të fondit dhe investitorit nëse investitori ka deklaruar se ka akses të rregullt në internet dhe një adresë elektronike.

KREU V
NJOFTIMI I NDRYSHIMEVE TE INVESTITORËT

Neni 61

Kërkesa për miratim paraprak të ndryshimeve të rëndësishme

1. Çdo ndryshim i rëndësishëm i shoqërisë administruese të fondit të investimeve me ofertë publike, të shoqërisë së investimeve dhe fondit të investimeve me ofertë publike miratohet nga Autoriteti sipas parashikimeve të neneve 65 dhe 77 të Ligjit.
2. Çdo ndryshim i rëndësishëm i prospektit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike miratohet nga Autoriteti sipas parashikimeve të nenit 92 të Ligjit.
3. Përveç sa parashikohet në nenin 92 të Ligjit, shoqëria administruese njofton çdo ndryshim të propozuar të veprimtarisë së sipërmarrjes ose nënfondit që, në përputhje me këtë nen, përbën një ndryshim të rëndësishëm dhe është subjekt i njoftimit të këtij ndryshimi të aksionarët ose mbajtësit e kuotave.

Neni 62

Ndryshimet e rëndësishme në një fond investimi me pjesëmarrje të hapur ose me intervale që është sipërmarrje furnizuese

1. Kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues njoftohet për ndryshime në lidhje me sipërmarrjen kryesore ose nënfondin e saj kryesor, ndryshime të cilat ndikojnë në sipërmarrjen ose nënfondin furnizues, shoqëria administruese e fondit, nëse ndryshimi është një ndryshim i rëndësishëm në përputhje me ligjin, njofton investitorët në sipërmarrjen ose nënfondin furnizues.
2. Pas miratimit nga autoriteti, shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues njofton për ndryshimet e rëndësishme drejtpërdrejt me postë normale ose postë elektronike të gjithë mbajtësit e kuotave dhe e publikon në faqen e internetit të shoqërisë administruese gjatë gjashtëdhjetë ditëve pune, përpara ditës së implementimit të këtyre ndryshimeve.
3. Ndryshimi i objektivit dhe politikës së investimit të sipërmarrjes ose të nënfondit kryesor që ndryshon profilin e tij të riskut përbën një ndryshim të rëndësishëm për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues dhe për pasojë zbatohen kërkesat e nenit 92 të Ligjit.

KREU VI
VËNIA NË DISPOZICION E RAPORTEVE DHE PASQYRAVE FINANCIARE
VJETORE DHE TË NDËRMJETME

Neni 63

Përgjegjësia për raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme

Shoqëria administruese për çdo SIK me ofertë publike dhe për çdo shoqëri investimi me ofertë publike që administron, përgatit raporte dhe pasqyra financiare vjetore dhe të ndërmjetme në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe i vë ato në dispozicion në përputhje me këtë rregullore dhe kërkesat e Seksionit 8 të Kreut V të Ligjit.

Neni 64

Raportet dhe pasqyra financiare vjetore të sipërmarrjeve të licencuara

1. Raportet dhe pasqyra financiare vjetore të sipërmarrjeve ose nënfondeve të licencuara përmbajnë informacionin e kërkuar në nenin 121, pikën 4 të Ligjit.
2. Publikimi i raporteve dhe pasqyra financiare vjetore të sipërmarrjeve ose nënfondeve të licencuara bëhet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve.

Neni 65

Raportet dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme të sipërmarrjeve të licencuara

1. Raportet dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme të sipërmarrjeve ose nënfondeve të licencuara përmbajnë informacionin e kërkuar në nenin 122, pikën 4 të Ligjit.
2. Publikimi i raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme të sipërmarrjeve ose nënfondeve të licencuara bëhet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve.

Neni 66

Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore të sipërmarrjeve ombrellë

1. Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore të sipërmarrjes ombrellë përgatiten për të gjithë sipërmarrjen në tërësi dhe përmbajnë:
 - a) Për çdo sipërmarrje ombrellë informacionin e kërkuar sipas nenit 64 të kësaj rregulloreje në lidhje me këtë sipërmarrje; dhe

- b) Për çdo nënfond informacionin e kërkuar sipas nenit 64 të kësaj rregulloreje në lidhje me këtë nënfond.

Neni 67

Raportet dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme të sipërmarrjeve ombrellë

- 1. Raportet dhe pasqyrat financiare të ndërmjetme të sipërmarrjes ombrellë përgatiten për të gjithë sipërmarrjen në tërësi dhe përmbajnë:
 - a) Për çdo sipërmarrje ombrellë informacionin e kërkuar sipas nenit 65 të kësaj rregulloreje në lidhje me këtë sipërmarrje; dhe
 - b) Për çdo nënfond informacionin e kërkuar sipas nenit 65 të kësaj rregulloreje në lidhje me këtë nënfond.

Neni 68

Nënshkrimi i raporteve dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme

- 1. Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të sipërmarrjes dhe të nënfondit duhet, në rastin e një shoqërie të licencuar të investimit:
 - a) Të miratohen nga personat kyç të shoqërisë së investimit;
 - b) Të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i shoqërisë administruese të fondit dhe drejtori i përgjithshëm i shoqërisë së investimit.
- 2. Raportet dhe pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme të sipërmarrjes ose të nënfondit duhet, në rastin e një fondi të licencuar të investimit:
 - a) Të miratohen nga personat kyç të shoqërisë administruese të fondit;
 - b) Të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm dhe drejtori i financës së shoqërisë administruese të fondit.

KREU VII

NJOFTIMI I ÇMIMEVE TË AKSIONEVE DHE TË KUOTAVE DHE VLERAVE NETO TË AKTIVEVE TË SIPËRMARRJEVE TË LICENCUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Neni 69

Njoftimi i çmimeve të kuotave të fondeve të licencuara të investimeve me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale

1. Shoqëria administruese publikon, përkatësisht çdo ditë, çmimin e emetimit të shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të secilit fond të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike ose nënfond që administron, sa herë që i emeton, shet, riblen ose shlyen këto kuota, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti.
2. Shoqëria administruese publikon në faqen e saj të internetit të paktën dy herë në vit çmimin e emetimit, të shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të secilit fond të investimeve me intervale me ofertë publike ose nënfond që administron sa herë që emeton, shet, riblen ose shlyen këto kuota, sipas rregullave të përcaktuara nga autoriteti.
3. Çmimet që duhen të publikohen sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni publikohen në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve në të njëjtën ditë të llogaritjes dhe nëse kërkohet nga Autoriteti, do t'i njoftohen edhe Autoritetit.

Neni 70

Informimi i vlerës së aktiveve neto për çdo aksion ose kuotë për sipërmarrjet e licencuara me pjesëmarrje të mbyllur

1. Shoqëria administruese e fondeve publikon, jo më pak se një herë në vit në intervale të rregullta, vlerën e aktiveve neto për çdo aksion ose kuotë për sipërmarrjet me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike që administron.
2. Vlera e aktiveve neto për çdo aksion ose kuotë që duhet të publikohen sipas pikës 1 të këtij neni publikohen në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve në të njëjtën ditë të llogaritjes dhe nëse kërkohet nga Autoriteti, do t'i njoftohen edhe Autoritetit.
3. Çmimi i aksionit ose kuotës së sipërmarrjes kolektive të investimeve të licencuar me pjesëmarrje të mbyllur që është e listuar ose e tregtuar në një treg të rregulluar publikohet siç kërkohet nga rregullat e këtij tregu.

KREU VIII

ANKESAT LIDHUR ME SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE TË LICENCUARA

Neni 71

Përgjegjësia për trajtimin e ankesave

1. Shoqëria administruese e fondeve emëron një personel kyç me përgjegjësinë për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së subjektit të licencuar sipas dispozitave të këtij Kreu i cili nuk është i njëjtë me personin e ngarkuar për trajtimin e ankesave.
2. Shoqëria administruese e fondeve raporton në Autoritet ankesat pa emrat e ankuesve. Emrat e ankuesve vihen menjëherë në dispozicion të Autoritetit vetëm me kërkesën e këtij të fundit.

Neni 72

Procedura për trajtimin e ankesave

1. Shoqëria administruese e fondeve harton dhe zbaton procedura për trajtimin e ankesave.
2. Procedura e trajtimit të ankesave përcakton: veprimet që do të ndërmerren nga shoqëria administruese e fondeve për trajtimin e ankesave.
3. Ankesat duhet të bëhen në mënyrë elektronike ose me shkrim në adresën zyrtare elektronike ose postare të shoqërisë administruese të fondeve, të cilat regjistrohen dhe më pas shqyrtohen.
4. Procedurat e trajtimit të ankesave të shoqërisë administruese të fondeve marrin parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të subjektit të licencuar.

Neni 73

Kontrollet e trajtimit të ankesave

Shoqëria administruese e fondeve duhet të vendosë sisteme kontrolli dhe të ndërmarrë hapa të përshtatshme për të siguruar që në trajtimin e ankesave të identifikohet dhe të rregullohet çdo problem.

Neni 74

Trajtimi i ankesave

1. Duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të subjektit të licencuar, shoqëria administruese e fondeve në trajtimin e ankesave duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
 - a) Mbledhjen e informacionit mbi shkaqet e ankesave dhe produktet e shërbimet lidhur me këto ankesa, si dhe informacionin mbi zgjidhjen e rasteve analoge, brenda 3 ditëve pune që nga dita e pranimit të ankesës;
 - b) Identifikimin e shkaqeve thelbësore të ankesave;
 - c) Përcaktimin e prioritetëve në trajtimin e ankesave;

- d) Shqyrtimin nëse shkaqet thelbësore të identifikuara mund të ndikojnë në procese ose fonde të tjerë;
- e) Marrjen e vendimit nëse shkaqet thelbësore të identifikuara duhet të korrigjohen dhe se si duhet të bëhet kjo;
- f) Raportimin e rregullt tek personi ose anëtari i personelit kyç përgjegjës nëse nevojiten nga ana e tyre informacione për probleme të përsëritura në mënyrë që ata të luajnë rolin e tyre në identifikimin, matjen, menaxhimin dhe kontrollin; dhe
- g) Mbajtjen e të dhënave të analizave dhe vendimeve të marra nga personat ose anëtari i personelit kyç në përgjigje të informacionit të menaxhimit mbi shkaqet thelbësore të ankesave.

Neni 75

Rezultatet e trajtimit të ankesave

1. Nëse shoqëria administruese e fondit identifikon probleme nga ankesat ose çështje të përsëritura, atëherë merr vendim në lidhje me pozicionin e konsumatorëve që mund të kenë pësuar dëm dhe që janë potencialisht të pafavorizuar nga këto probleme, por që nuk janë ankuar, për t'iu siguruar që edhe këtyre konsumatorëve tu jepet dëmshpërblimi i duhur menjëherë. Në veçanti, subjekti i licencuar duhet:
 - a) Të konstatojë shkaktuesin dhe pasojat e dëmit që mund t'i jetë shkaktuar konsumatorit; dhe
 - b) Të shqyrtojë nëse është e drejtë dhe e arsyeshme që të ndërmarrë në mënyrë proaktive një veprim korrigjues, i cili mund të përfshijë kontaktimin e klientëve të cilët nuk janë ankuar.

Neni 76

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesave

1. Pas marrjes së ankesës, shoqëria administruese e fondit ndërmerr hapat e më poshtme:
 - a) Shqyrton ankesën në mënyrë profesionale dhe të paanshme si dhe merr informacione shtesë sipas nevojës;
 - b) Vlerëson në mënyrë të drejtë, të vazhdueshme dhe të menjëhershme:
 - i. Cili është subjekti i ankesës;
 - ii. Nëse ankesa është e drejtë;
 - iii. Çfarë veprimi korrigjues ose dëmshpërblimi (ose të dyja) mund të jenë të përshtatshme; dhe
 - iv. Gjykon nëse ka baza të arsyeshme për t'u bindur se një subjekt tjetër i licencuar mund të jetë përgjegjës vetëm ose bashkërisht për problematikën e pretenduar në ankesë.

Neni 77

Korrigjimi ose dëmshpërblimi

1. Në lidhje me ankesat, shoqëria administruese e fondit duhet të ofrojë sa më poshtë:
 - a) Korrigjim dhe/ose dëmshpërblim nëse vendosin se kjo është e përshtatshme;
 - b) Shpjegimin menjëherë ankuesit dhe, në një mënyrë të drejtë, të qartë dhe jo çorientuese, vlerësimin për ankesën, vendimin mbi këtë ankesë dhe ofrimin e veprimeve korrigjuese dhe/ose dëmshpërblyese;
 - c) Zbatimin menjëherë të veprimit korrigjues dhe/ose të dëmshpërblimit në rastet kur:
 - i. Është pranuar nga ankuesi;
 - ii. Ka shkelje të ligjit dhe rregulloreve në fuqi; dhe
 - iii. Parashikohet në pikën 1 të nenit 75 të kësaj rregullore.

Neni 78

Komunikimet me ankuesin

1. Pas pranimit të ankesës, shoqëria administruese e fondit brenda afatit prej 2 (dy) ditësh pune nga data e marrjes së ankesës, i dërgon ankuesit një njoftim të menjëhershëm me shkrim duke e informuar se e ka marrë ankesën dhe se po e trajton atë, si dhe do të informohet më pas për progresin e masave që merren për zgjidhjen e ankesës.
2. Shoqëria administruese e fondit duhet, brenda 20 ditëve pune pas pranimit të ankesës, t'i dërgojë ankuesit përgjigje me shkrim ku e informon se:
 - a) Pranon ankesën dhe, aty ku është e përshtatshme, ofron dëmshpërblim ose korrigjim; ose
 - b) Refuzon ankesën dhe jep arsye për këtë;
3. Në rastet kur ankuesi nuk është dakord me përgjigjen e shoqërisë, ai mund të parashtrojë ankesën e tij pranë Autoritetit ose Gjykatës.
4. Nëse shoqëria administruese e fondit nuk e zgjidh ankesën brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, atëherë vepron sa më poshtë:
 - a) I shpjegon ankuesit pse nuk është në gjendje të japë një përgjigje përfundimtare dhe e informon se kur pritet të japë një përgjigje të tillë, por pa tejkaluar afatin e 20 ditëve të tjera pune; ose
 - b) Informon ankuesin se mund t'ia parashtrojë ankesën Autoritetit.

Neni 79

Dërgimi i ankesës te një subjekt tjetër i licencuar

1. Shoqëria administruese e fondit kur ka baza të arsyeshme dhe bindet se një subjekt tjetër i licencuar mund të jetë vetëm ose bashkërisht përgjegjës për çështjen e pretenduar në ankesë, duhet ta dërgojë ankesën ose pjesën përkatëse me shkrim tek ai subjekt tjetër i licencuar.
2. Dërgimi i ankesës bëhet në mënyrë të menjëhershme tek subjekti tjetër i licencuar dhe informon menjëherë ankuesin duke i dhënë edhe detajet e kontaktit të subjektit tjetër të licencuar.
3. Nëse shoqëria administruese e fondeve është bashkërisht përgjegjëse për çështjen e pretenduar në ankesë, ajo përmbush detyrimet e veta sipas këtij kreu në lidhje me atë pjesë të ankesës që nuk e ka kaluar te subjekti tjetër.
4. Kur një shoqëri administruese dërgon ankesën ose pjesën përkatëse me shkrim tek një subjekt tjetër i licencuar, ky i fundit do ta trajtojë sikur ankesa të ishte bërë dhe të ishte pranuar direkt nga subjekti tjetër i licencuar.
5. Pas pranimi të një ankese të dërguar, afatet e përcaktuara në nenin 78 të kësaj rregulloreje zbatohen nga data në të cilën subjekti i licencuar merr ankesën e dërguar.

Neni 80

Mbajtja e regjistrimit të ankesave

1. Shoqëria administruese e fondit ruan në një regjistër çdo ankesë të parashtruar dhe masat e marra për zgjidhjen e secilës prej tyre dhe i ruan këto të dhëna sipas periudhës së aplikueshme të përcaktuar me legjislacionin në fuqi për arkivat, nga data e pranimi të ankesës.
2. Regjistrimet e masave të marra për zgjidhjen e ankesave mund të përdoren për të ndihmuar në mbledhjen e informacionit të menaxhimit dhe raportimin e rregullt tek personat dhe personeli kyç i shoqërisë administruese të fondit.

Neni 81

Informimi i Autoritetit

1. Shoqëria administruese e fondeve vë në dispozicion të personave kyç të shoqërisë dhe të Autoritetit, një raport të plotë lidhur me ankesat e marra, minimalisht në fund të çdo tremujori ose më shpesh me kërkesë të Autoritetit.
2. Raporti duhet të paraqitet në formatin e treguar në shtojcën 6 të rregullores për licencimin.

Neni 82
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit.
2. Kjo rregullore zbatohet për çdo sipërmarrje të investimeve kolektive të licencuara pas datës së miratimit të kësaj rregulloreje.
3. Shoqëritë administruese të fondeve për secilën sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuar para datës së miratimit të kësaj rregulloreje, duhet të përshtatin veprimtarinë e SIK me ofertë publike me kërkesat e kësaj rregulloreje si dhe të depozitojnë në Autoritet dokumentacionin përkatës brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA 1

Përmbajtja e dokumentit me informacionin kryesor për investitorin

1. Kjo shtojcë përmban kërkesat kryesore lidhur me informacionin kryesor për investitorin, i cili parashikohet nga kërkesat e këtij ligji. Kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë do të zbatohen nga çdo shoqëri administruese në lidhje me çdo Sipërmarrje të Investimeve Kolektive (SIK), që ajo ka nën administrim.
2. Karakteristikat thelbësore të informacionit kryesor për investitorin:
 - a) Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë i paanshëm, i qartë dhe jo çorientues;
 - b) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin jepet në mënyrë të tillë, që investitori të jetë në gjendje ta dallojë atë nga materiale të tjera për SIK. Veçanërisht, informacioni nuk duhet të paraqitet ose të shpërndahet në mënyrë të tillë që investitorët ta konsiderojnë atë si më pak të rëndësishëm se informacionet e tjera rreth SIK dhe rreziqeve e përfitimeve të saj;
 - c) Informacioni kryesor për investitorin duhet të jetë në përputhje me pjesët përkatëse prospektit;
 - ç) Informacioni kryesor i jepet investitorit pa pagesë.
3. Koha e vënies në dispozicion të informacionit kryesor:
 - a) Shoqëria administruese, përpara se investitori të nënshkruajë kuotat/aksionet e SIK, i jep këtij të fundit informacionin kryesor për çdo SIK që ka nën administrim.
 - b) Në rastin e shitjes së kuotave/aksioneve SIK, nëpërmjet një agjenti, ky i fundit është i detyruar t'i japë investitorit informacionin kryesor përpara nënshkrimit të kuotave/aksioneve të SIK.
4. Prezantimi dhe gjuha e dokumentit të informacionit kryesor:
 - a) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin duhet të jetë:
 - i. I paraqitur dhe i parashtruar në një mënyrë të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur shkronja të një madhësie të lexueshme;
 - ii. I shprehur qartë dhe i shkruar me një gjuhë që i krijon lehtësi investitorit të kuptojë informacionin të cilin po i komunikohet, veçanërisht gjuha e përdorur duhet të jetë e qartë, e përmbledhur dhe e kuptueshme; duhet të shmangë përdorimin e fjalëve të huaja dhe të pakuptueshme për publikun, si dhe dialektalizmat; të përmbajë, aty ku mundet, fjalë të përditshme dhe duhet të shmangë termat teknikë;
 - iii. I fokusuar tek informacioni kryesor për të cilin ka nevojë investitori.

- b) Në rastin kur dokumenti origjinal me informacionin kryesor është i përgatitur me ngjyra printimi apo fotokopjimi në bardhezi nuk duhet të ndikojë në zvogëlimin e shkallës së të kuptuarit të informacionit.
- c) Përdorimi i logos së shoqërisë administruese apo grupit të cilit ajo i përket, duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos i tërheqë vëmendjen investitorit apo të nënvlerësojë tekstin e dokumentit.
- ç) Dokumenti i printuar me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të jetë më shumë se dy faqe të formatit A4.

5. Elementet që duhet të përmbajë informacioni kryesor:

- a) Informacioni kryesor për investitorin duhet të japë informacionin mbi SIK, mbështetur në elementet e mëposhtme:
 - i. Pjesa hyrëse dhe identifikimi i SIK;
 - ii. Një përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit;
 - iii. Profili i riskut dhe i përfitimit nga investimi, duke përfshirë udhëzues të duhur dhe paralajmërime në lidhje me risqet që shoqërojnë investimin në SIK përkatëse;
 - iv. Komisionet dhe tarifatat;
 - v. Paraqitja e ecurisë dhe rezultateve në të kaluarën (kur është e përshtatshme), si dhe skenarë të rezultateve për të ardhmen;
 - vi. Informacion tjetër praktik.
- b) Këto elemente thelbësore duhet të jenë të kuptueshme për investitorin dhe duhet të sqarohen qartë, pa qenë nevoja të jepen referenca në dokumente të tjera.
- c) Format i standardizuar në lidhje me elementët e përcaktuar më lart jepet në mënyrë të detajuar në tabelën, pjesë përbërëse të kësaj shtojce.

6. Pjesa hyrëse e dokumentit dhe identifikimi i SIK:

- a) Titulli i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin vendoset në krye të faqes së parë, duke përdorur shprehjen: *“Informacion kryesor për investitorin”*.
- b) Poshtë titullit jepet një deklaratë, ku thuhet: *“Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t’ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.”*
- c) Poshtë deklaratës jepen të dhëna identifikuese mbi SIK, duke përfshirë të paktën llojin e SIK (fond apo shoqëri investimi), emërtimin e SIK, llojin e SIK duke u nisur nga politika e investimit, emrin e shoqërisë administruese. Në rastet kur shoqëria administruese bën pjesë në një grup shoqërisë, për qëllime ligjore, administrative ose marketingu, mund të jepet edhe emërtimi i grupit. Emërtimi i grupit jepet nëse nuk krijon pengesë për investitorin që të kuptojë elementet

kryesore të investimit dhe pakëson mundësinë e tij për të krahasuar produktin investimit.

- ç) Në pjesën hyrëse të dokumentit duhet të përfshihet edhe një deklaratë ku të theksohet se kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, se investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, se SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe se rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

7. Përshkrim i shkurtër i objektivave dhe politikave të investimit:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “*Objektivat dhe politika e investimit*” përbën një nga seksionet e rëndësishme për informimin e investitorit. Ky seksion është i detyrueshëm për t’u përfshirë në dokument edhe në rastet kur përshkrimi i objektivave dhe i politikës së investimit nuk është paraqitur në prospekt. Ky seksion duhet të përmbajë:

- a) Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare që janë objekt i investimit.
- b) Deklaratën që investitori mund të shlyejë/shesë kuota/aksione të SIK, sipas kërkesës së tij/saj, dhe sa shpesh mund ta bëjë këtë.
- c) Një objektiv të caktuar të SIK (nëse ka) në lidhje me sektorët e industrisë, terrenin gjeografik apo sektorë të tjerë të tregut ose klasa specifike të aseteve.
- ç) Deklaratën nëse SIK lejon zgjedhje të lira në lidhje me investime të veçanta të lejueshme dhe nëse SIK i referohet një *benchmark*-u dhe cili është ky.
- d) Deklaratën nëse të ardhurat nga SIK shpërndahen apo rinvestohen.
- dh) Informacion tjetër, që vlerësohet se është i përshtatshëm, si:
 - i. Kur SIK investon në letrat me vlerë të borxhit, duhet të tregohet nëse ato janë emetuar nga shoqëritë, qeveritë apo subjekte të tjera;
 - ii. Informacion në lidhje me ndonjë pagesë të paracaktuar dhe faktorët që parashikohet të ndikojnë në performancën e SIK;
 - iii. Nëse strategjia e investimeve udhëhiqet nga rritja, përzgjedhja e instrumenteve, bazuar në vlerësimin e brendshëm ose dividendët më të lartë;
 - iv. Si mund të ndikojnë në performancën e SIK përdorimi i teknikave, të tilla si: teknikat e mbrojtjes, arbitrazhi apo përdorimi i levës financiare;
 - v. Nëse kostot e transaksioneve të portofolit do të kenë një ndikim material mbi performancën;
 - vi. Afati minimal i rekomanduar për investimin në SIK.

8. Profili i riskut dhe përfitimi nga investimi:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “*Profili i riskut dhe përfitimit*”, duhet të përmbajë:

- a) Një tregues sintetik mbi riskun dhe përfitimin e përllogaritur, sipas metodologjisë së nxjerrë nga autoriteti me udhëzim;

- b) Një shpjegim me fjalë të treguesit dhe kufizimeve të tij kryesore, i cili duhet të përfshijë informacionin, si më poshtë:
- i. Një deklaratë se të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit sintetik mund të mos jenë të dhëna të besueshme për profilin e ardhshëm të riskut të SIK;
 - ii. Një deklaratë se kategoria e treguar e riskut dhe e përfitimit nuk garantohej se do të mbetet e pandryshuar dhe se kategoria e riskut me kalimin e kohës mund të ndryshojë;
 - iii. Një deklaratë se kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk;
 - iv. Një shpjegim i shkurtër se përse SIK është në kategorinë përkatëse;
 - v. Detaje për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje të ofruar nga SIK për kapitalin e investitorit, duke përfshirë këtu efektet e mundshme për shlyerjen e kuotave jashtë periudhës së garantuar ose të mbrojtur.
- c) Një shpjegim me fjalë të rreziqeve materialisht të lidhur me SIK dhe që nuk paraqiten mjaftueshëm nga treguesi sintetik, siç janë:
- i. Risku i kredisë, në rastet kur instrumentet e borxhit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të portofolit;
 - ii. Risku i likuiditetit, në rastin kur investimi është në një nivel të konsiderueshëm në instrumente financiare, të cilat prej natyrës, në rrethana të caktuara, mund të kenë një nivel të ulët likuiditeti, aq sa mund të ketë një ndikim mbi nivelin e riskut të likuiditetit të SIK në tërësi;
 - iii. Risku i kundërpalës, kur SIK garantohej nëpërmjet garancisë së një pale të tretë ose kur ka ekspozim material, si rezultat i ekspozimeve me palë të treta;
 - iv. Risku operacional që rezulton nga kujdestaria apo ruajtja e aktiveve;
 - v. Ndikimi që ka përdorimi i teknikave, siç mund të jenë përdorimi i derivativeve, kur këto teknika përdoren për të rritur, për të zvogëluar ekspozimin e aseteve.

9. Komisionet dhe tarifat:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Komisionet dhe tarifat e SIK”, duhet të përmbajë fillimisht një deklaratë rreth rëndësisë së komisioneve dhe tarifave, të cilat përdoren për të paguar kostot e administrimit të SIK, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave/aksioneve të SIK. Deklarata duhet të cilësojë se komisionet dhe tarifat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

- a) Komisionet dhe tarifat në seksionin “Komisionet dhe tarifat e SIK” paraqiten në formën e një tabele, ku përfshihen:
- i. Komisione/tarifa të njehershme përpara ose pas investimit. Këtu përfshihen komisionet dhe tarifat e hyrjes dhe daljes nga SIK. Këto pagesa shprehen në përqindjen maksimale të tyre, që nënkuptojnë shumën maksimale që duhet

- të paguhet nga investitori për llogari të SIK, para investimit dhe shumën maksimale para daljes nga SIK;
 - ii. Komisionet dhe tarifatat e vazhdueshme, që paraqiten në një shifër të vetme dhe që njihen si detyrime në vazhdim;
 - iii. Komisionet dhe tarifatat e SIK në kushte të veçanta, ku tabela duhet të listojë dhe shpjegojë edhe çdo komision apo tarifë tjetër, sipas kushteve specifike të SIK, bazën mbi të cilën llogaritet dhe aplikohet ky detyrim.
- b) Për secilën nga komisionet apo tarifatat e specifikuar në tabelë duhet të jepet një shpjegim me fjalë, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
- i. Në lidhje me “komisionet apo tarifatat e hyrjes dhe daljes” duhet të bëhet e qartë se shifrat e paraqitura janë shifra maksimale, pasi në disa raste investitori mund të paguajë më pak, për këtë fakt investitori mund të informohet nga këshilltari i tij i investimit;
 - ii. Në lidhje me “komisionet apo tarifatat vjetore të vazhdueshme”, duhet të bëhet një deklaratë se kjo shifër bazohet në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen:
 - Tarifa e performancës; dhe
 - Kostot e transaksioneve të portofolit, duke përfshirë rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK, të tjera.
- c) Seksioni për komisionet apo tarifatat duhet të japë referencën për ato pjesë të prospektit të SIK, ku jepet informacioni më i detajuar rreth komisioneve apo tarifave.

10. Paraqitja e performancës së kaluar:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Paraqitja e performancës së kaluar”, jep informacion rreth performancës së SIK për periudhat e mëparshme, duke e paraqitur në një grafik dhe duke treguar performancën e SIK (normën e kthimit) për 10 vitet e fundit:

- a) Paraqitja grafike e lartpërmendur duhet të jetë e lexueshme, por në asnjë rrethanë nuk duhet të jetë më shumë se gjysmë faqe e formatit A4, të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin.
 - b) SIK, me një aktivitet më pak se pesë vite të plota kalendarike, duhet të përdorë një prezantim, ku paraqiten vetëm pesë vitet e fundit. Për çdo vit për të cilin nuk ka të dhëna, ai duhet të paraqitet bosh dhe nuk bëhet asnjë shënim tjetër përveç datës.
 - c) SIK, për të cilën ende nuk ka të dhëna mbi performancën për një vit të plotë kalendarik, duhet të paraqesë një deklaratë ku shpjegohet se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të siguruar një tregues të dobishëm për performancën e kaluar të investitorit.
- ç) Grafiku duhet të shoqërohet nga deklaratat, ku të shfaqen dukshëm:
- i. Paralajmërimi për vlerën e kufizuar që ai ka si udhërrëfyes për performancën e ardhshme;
 - ii. Paraqitja shkurtimisht e komisioneve apo tarifave, të cilat janë përfshirë

- apo përjashtuar në përlllogaritjen e performancës së kaluar;
- iii. Paraqitja e vitit, kur SIK filloi të emetojë kuota/aksione;
 - iv. Paraqitja e monedhës në të cilën është përlllogaritur performanca e kaluar.
- d) Dokumenti me informacionin kryesor për investitorin nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë të vitit aktual kalendarik, duke e konsideruar si performancë e kaluar.
 - dh) Përlllogaritja e shifrave të performancës së kaluar duhet të bazohet në vlerën neto të aseteve të SIK, dhe duhet të mbahet parasysh nëse të ardhurat nga investimi i aseteve të SIK janë riinvestuar.
 - e) Në rastin e një ndryshimi në objektivat dhe politikën e investimit me efekt material gjatë periudhës së paraqitur në grafik, performanca e kaluar e SIK vazhdon të pasqyrohet para këtij ndryshimi material. Periudha para ndryshimit me efekt material duhet të tregohet në grafik dhe të etiketohet me një paralajmërim të qartë se kjo performancë është arritur në rrethana që nuk aplikohen më.

11. Informacioni praktik:

Seksioni i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, i titulluar “Informacion praktik”, përmban informacionin, si më poshtë:

- a) Emrin e depozitarit;
- b) Ku dhe si do të sigurohet informacioni i mëtejshëm rreth SIK (prospekt, raporte dhe pasqyra financiare);
- c) Ku dhe si do të sigurohet informacioni praktik (p.sh. çmimet me të fundit të kuotave/aksioneve);
- ç) Një deklaratë që legjislacioni tatimor mund të ketë një ndikim në tatimin personal të investitorit - shtetas i huaj.
- d) Një deklaratë me këtë përmbajtje “*Shoqëria administruese mund të konsiderohet përgjegjëse e vetme për çdo keqkuptim, pasaktësi ose parregullsi që gjendet në këtë dokument, në ndryshim nga pjesët përkatëse të prospektit të SIK*”.

12. Seksioni përmbyllës i dokumentit:

- a) Në seksionin përmbyllës të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin përfshihen detajet e licencës së shoqërisë administruese dhe të SIK;
- b) Dokumenti mbyllet me deklaratën: “*Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit*”.

13. Rishikimi i informacionit kryesor për investitorin:

- a) Shoqëria administruese duhet të bëjë një rishikim të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin të paktën çdo dymbëdhjetë muaj;
- b) Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, rishikimi i dokumentit duhet të bëhet përpara ndryshimit të propozuar të prospektit dhe të rregullave të SIK;
- c) Rishikimi duhet të kryhet përpara ose gjatë çdo ndryshimi që konsiderohet me efekt material për informacionin që përmban dokumenti me informacionin kryesor për investitorin.

14. Publikimi i dokumentit të rishikuar:

Dokumenti i rishikuar duhet të vihet menjëherë në dispozicion të investitorit:

- a) Dokumenti i rishikuar duhet të vihet në dispozicion të investitorit, përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi;
- b) Dokumenti i rishikuar, si rezultat i korrigjimit të seksionit mbi performancën e kaluar të SIK duhet të vihet në dispozicion të investitorit, jo më vonë se 35 ditë pune, pas datës 31 dhjetor të çdo viti.

15. Mënyrat e dhënies të informacionit kryesor për investitorin:

- a) Shoqëria administruese dhe çdo SIK nën administrimin e saj jep informacion kryesor për investitorin, duke e publikuar në formë dokumenti elektronik në *website*, ose *mjet të qëndrueshëm të komunikimit*. Kopja e dokumentit i dërgohet investitorit me letër, sipas kërkesës dhe pa pagesë;
- b) Dokumenti i rishikuar me informacionin kryesor për investitorin publikohet në *website*-in e shoqërisë administruese.

16. Kushtet për dhënien e informacionit nëpërmjet *një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit*:

- a) Informacioni kryesor për investitorin jepet nëpërmjet *një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit*, kur plotësohen kushtet si më poshtë:
 - i. Marrëdhënia e biznesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe
 - ii. Investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *mjetit të qëndrueshëm të komunikimit*.
- b) Kur dokumenti, mbi informacionin kryesor për investitorin do të jepet nëpërmjet *website*-it dhe ky informacion nuk do të adresohet personalisht tek investitori, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - i. Marrëdhënia e biznesit ndërmjet shoqërisë administruese dhe investitorit ka filluar ose po fillon; dhe
 - ii. Investitori zgjedh të marrë informacionin kryesor për investitorin nëpërmjet *website*-it;
 - iii. Investitori duhet të njoftohet në mënyrë elektronike për adresën e *website*-it dhe vendin e *website*-it, ku informacioni është i aksesueshëm;
 - iv. Informacioni duhet të jetë i përditësuar;
 - v. Informacioni në këtë *website* duhet të jetë i aksesueshëm në mënyrë të vazhdueshme, për sa kohë investitori mund të ketë nevojë për ta kontrolluar.

17. Dërgimi në autoritet:

- a) Shoqëria administruese për çdo SIK nën administrim dërgon në autoritet një kopje të dokumentit me informacionin kryesor për investitorin, si dhe çdo amendim të këtij dokumenti;
- b) Ky dokument, me informacionin kryesor për investitorin duhet të përmbajë informacionet më të fundit.

18. TABELA: FORMAT I STANDARDIZUAR MBI PËRMBAJTJEN E DOKUMENTIT:
INFORMACIONI KRYESOR PËR INVESTITORIN

<p>Informacioni kryesor për investitorin</p> <p>Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.</p> <p>Kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.</p>
<p>Fondi (SIK) “123”, nënfond i fondit “ABC” (ISIN: 4321) Ky fond administrohet nga shoqëria administruese “Administrues të fondeve ABC sh.a.”, pjesë e grupit të shoqërive “XYZ”</p>
<p>Objektivat dhe politika e investimit</p>

Përshkrim i përbashkët i objektivave dhe politikës së SIK, me një gjuhë të thjeshtë (të mos kopjohet fjalë për fjalë nga prospekti)

Karakteristikat kryesore të produktit, të cilat duhet t'i bëhen të ditura investitorit si në vijim:

- Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare të lejuara, që janë objekt i investimit;
- Një deklaratë që investitori mund të shlyejë kuotat sipas kërkesës, dhe sa shpesh tregtohen kuotat;
- Nëse SIK ka një objektiv të veçantë në lidhje me investimet e kategorizuara në sektorë, industriale, gjeografike, apo çfarëdo kategorizimi tjetër të tregut apo nëse ka objektiv investimin në klasa të veçanta të aktiveve;
- Nëse lejohen ose jo zgjedhjet diskrecionare lidhur me investime të caktuara dhe nëse SIK mbështetet ose jo në një tregues referencë (*benchmark*), nëse po, në cilin;
- Deklaratë nëse të ardhurat që lindin nga SIK shpërndahen apo rinvestohen.

Informacione të tjera, nëse kanë lidhje, si më poshtë:

- Në cilat lloje të letrave me vlerë të borxhit investon SIK;
- Informacion lidhur me pagesa të paracaktuara dhe faktorët që pritët të përcaktojnë performancën;
- Nëse përzgjedhja e aktiveve orientohet nga rritja, vlerësimi apo dividendët e lartë;
- Cili është ndikimi i teknikave të mbrojtjes/arbitrazhit/levës financiare në performancën e SIK;
- Që kostot e transaksioneve të portofolit kanë ndikim material te performanca;
- Periudha minimale e rekomanduar e mbajtjes.

Profili i riskut dhe përfitimit

Risk i ulët

Përfitime

zakonisht të ulëta

Risk i lartë

Përfitime

zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Shpjegim narrativ i treguesit dhe i kufizimeve kryesore të tij:

- Të dhënat historike nuk mund të përdoren si indikatorë të qëndrueshëm për të përcaktuar të ardhmen;
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës;
- Kategoria më e ulët nuk nënkupton mungesën e plotë të riskut;
- Përse SIK ndodhet në kategorinë specifike;
- Të dhëna për natyrën, kohën dhe shtrirjen e çdo garancie apo mbrojtjeje mbi kapitalin.

Paraqitje narrative e rreziqeve të rëndësishme për SIK, të cilat nuk janë mbuluar sa duhet nga treguesi:

- Risku i kreditit, kur arrihet një nivel i konsiderueshëm investimesh në letra me vlerë të borxhit;
- Risku i likuiditetit, kur arrihet një nivel i konsiderueshëm investimesh në instrumente financiare, që kanë të ngjarë të kenë nivel të ulët likuiditeti në rrethana të caktuara;
- Risku i kundërpalës, kur SIK mbështetet me një formë garancie nga një i tretë ose ka ekspozim të konsiderueshëm investimi, si pasojë e kontratave të lidhura me palë të treta;
- Rreziqet operative, përfshirë mbajtjen në kujdestari dhe ruajtjen e aktiveve;
- Efekti i çdo lloj teknike të përdorur, si për shembull përdorimi i derivativeve.

Komisionet/tarifat e SIK

Komisionet/tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të SIK, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit tuaj

Komisione/tarifa të njehershme përpara ose pas investimit

Komisioni/tarifa i/e hyrjes - [] %
Komisioni/tarifa i/e largimit - [] %

Ky është maksimumi që mund të zbritet nga paratë tuaja [përpara se të investohet][përpara se të merrni të ardhurat e investimit tuaj].

Komisioni i hyrjes dhe i largimit paraqiten këtu me shifra maksimale. Në disa raste mund të paguani më pak – këtë mund ta mësoni nga këshilltari juaj financiar.

Shifra e **tarifave të vazhdueshme** mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më []. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihen:

Tarifat e performancës

Komisionet/tarifat që mbahen nga SIK gjatë periudhës së një viti

Komisione/tarifa [] %
në vazhdimësi

Kostot e veprimeve të portofolit, me përjashtim të rastit kur SIK paguan komision hyrjeje/dalje kur blen ose shet kuota të një sipërmarrjeje tjetër investimesh kolektive

Komisionet/tarifat e mbajtura nga SIK në kushte të veçanta

Komisioni/tarifa e performancës [] %

Për më shumë informacion për komisionet, ju lutemi shihni faqet nga x deri në x të prospektit të SIK, të cilin mund ta gjeni në [faqen e internetit]

Ecuria në të shkuarën

Kthimi në %	10%	Ky grafik plotësohet me fjali të qarta, të cilat: - Paralajmërojnë për vlerën e limituar të tij si udhëzues për performancën në të ardhmen; - Shpjegojnë shkurtimisht se cilat komisione e tarifa janë përfshirë, e cilat nuk janë
	7.5%	
	5%	
	2.5%	
	0%	

-2.5%	përfshirë; - Tregojnë vitin në të cilin është krijuar SIK; - Tregojnë monedhën me të cilën është llogaritur ecuria e së shkuarës.
-5%	
-7.5%	
-10%	
Vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019	

Informacione praktike

- Emri i depozitarit;
- Ku dhe si mund të merren informacione të mëtejshme për SIK (prospekti, raportet & pasqyrat financiare);
- Ku dhe si mund të merren informacione të tjera praktike (p.sh., ku mund të gjenden çmimet më të fundit të kuotave);
- Deklarim se legjislacioni tatimor i vendit të origjinës të SIK mund të ketë ndikim te pozicioni tatimor personal i investitorit;
- Deklarim se “[Emri i shoqërisë administruese] mban përgjegjësi ligjore vetëm në bazë të atyre që thuhet në këtë dokument, të cilat janë keqorientuese, të pasakta ose jo në përputhje me pjesët përkatëse të prospektit të SIK”;
- Informacion specifik lidhur me fondet ombrellë (p.sh. çdo transferim të drejtash ndërmjet nënfondeve);
- Informacion për klasat e tjera të aksioneve, nëse ka (informacionet kryesore për investitorin mund të mbështeten në një klasë përfaqësuese).

Ky SIK është miratuar në [emri i vendit] dhe rregullohet nga [identiteti i autoritetit kompetent].

[Emri i shoqërisë administruese] është licencuar në [emri i vendit ku është licencuar shoqëria administruese] dhe rregullohet nga [identiteti i autoritetit kompetent].

Këto informacione kryesore për investitorin janë të sakta në [datën e publikimit].

SHTOJCA 1.A

Llogaritja e shifrës së tarifave të vazhdueshme

1. Shoqëria administruese e sipërmarrjes:

- a) Është përgjegjëse për llogaritjen e shifrës së tarifave të vazhdueshme dhe për paraqitjen me saktësi në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin;
- b) Përcakton procedura që janë përputhje me këtë metodikë dhe dokumentohen në mënyrë të duhur;
- c) Mban evidenca të çdo llogaritjeje për një periudhë 5-vjeçare, pas datës së fundit që ky version i dokumentit me informacionin kryesor për investitorin është publikuar.

Përkufizimi i tarifave të vazhdueshme që duhen deklaruar

2. Në kuadër të dokumentit me informacione kryesore për investitorët, tarifat e vazhdueshme janë pagesat që u zbriten aktiveve të sipërmarrjes, kur këto zbritje kërkohen ose lejohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nga akti i themelimit të sipërmarrjes ose nga prospekti SIK. Shifra që përfshihet në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin mbështetet në totalin e të gjitha këtyre pagesave që bëhen gjatë një periudhe të veçantë, pa përfshirë përjashtimet e identifikuara më poshtë, në pikën 5 të kësaj shtojce.

3. Shifra e tarifave të vazhdueshme përfshin të gjitha llojet e kostove që mbulon sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, duke përfshirë shpenzime të domosdoshme gjatë veprimtarisë së saj, si dhe shpërblimet e çdo pale që ka lidhje me të ose që i ofron shërbime. Këto kosto mund të shprehen ose llogariten në një shumëllojshmëri mënyrash (p.sh. tarifë e sheshtë, përqindje e aktiveve, komision për transaksion etj.).

4. Lista e mëposhtme është orientuese, por nuk i shteron të gjitha llojet e tarifave të vazhdueshme që, nëse zbriten nga aktivet e sipërmarrjes, merren në konsideratë në shumën e deklaruar:

- a) Të gjitha pagesat e personave të mëposhtëm, përfshirë çdo person të cilit i janë deleguar funksione:
 - Shoqëria administruese e sipërmarrjes;
 - Personat kyç të sipërmarrjes nëse është shoqëri investimesh;
 - Depozitari;
 - Kujdestari/kujdestarët të cilit depozitari i delegon ruajtjen e aktiveve;
 - Çdo shoqëri e administrimit të portofolit.
- b) Të gjitha pagesat e personave që i ofrojnë shërbime me kontratë personave të lartpërmendur, përfshirë:
 - Ofruesit e shërbimeve të vlerësimit dhe kontabilitetit të fondeve;
 - Ofruesit e shërbimeve të mbajtësve të kuotave ose aksioneve, si agjenti i transferimit dhe subjekte ndërmjetësimi, që janë mbajtës evidencash të

aksioneve/kuotave të sipërmarrjes dhe që i ofrojnë nënshërbime kontabiliteti pronarëve përfitues të këtyre aksioneve.

- c) Taksa regjistrimi, tarifa rregullatore dhe tarifa të ngjashme.
- ç) Tarifat e auditimit;
- d) Pagesat për këshilltarët juridikë dhe profesionalë.

5. Komisionet dhe pagesat e mëposhtme nuk bëjnë pjesë në shumën që deklarohet si pjesë e tarifave të vazhdueshme në dokumentin me informacionin kryesor për investitorin:

- a) Tarifat ose komisionet e hyrjes/daljes ose çdo shumë tjetër që investitori paguan drejtpërdrejt ose që zbritet nga pagesa që bëhet nga investitori ose që i jepet investitorit;
- b) Interesa për huamarrje;
- c) Pagesat ndaj të tretëve për të mbuluar kostot e domosdoshme në lidhje me blerjen ose shitjen e çdo aktivi për portofolin e sipërmarrjes, pavarësisht nëse këto kosto janë të pritshme (për shembull, tarifa ndërmjetësimi, tatime dhe tarifa të lidhura) ose të papritshme (për shembull, kostot e tregtimit të titujve me interes fikse, kostot e ndikimit në treg);
- ç) Pagesat për mbajtjen e instrumenteve financiare derivative (për shembull, kërkesa e *broker*-it për para shtesë për të mbuluar diferencën e koston);
- d) vlerat e mallrave ose shërbimeve, që merr shoqëria administruese ose çdo person i lidhur në këmbim të ekzekutimit të urdhrave të tregtimit (komisionet e tërthorta ose masa të ngjashme).

6. Përjashtimi i kostove të lidhura me transaksionet në shkronjën “c”, të pikës 5, të kësaj shtojce, nuk mbulon:

- a) Pagesat, të lidhura me transaksionet kundrejt personave të përmendur në shkronjat “a” ose “b”, të pikës 4, të kësaj shtojce, në lidhje me të cilat marrësi nuk jep llogari përpara sipërmarrjes; të gjitha këto shuma të tilla merren në konsideratë në shifrën e deklaruar;
- b) Kostot e blerjes ose shitjes së kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive, të cilat duhet të merren në konsideratë në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 8, të kësaj shtojce.

7. Në përputhje me një marrëveshjeje për ndarjen e tarifave, shoqëria administruese ose një palë tjetër mund të mbulojë, tërësisht ose pjesërisht, kostot e shfrytëzimit të cilat normalisht do të përfshiheshin në shifrën e tarifave të vazhdueshme:

- a) Çdo shpërblim i punës së shoqërisë administruese (ose të një personi tjetër), që bëhet në zbatim të marrëveshjeve të tilla për ndarjen e tarifave merret në konsideratë dhe mblidhet në shifrën totale të tarifave të vazhdueshme. Shembuj të mundshëm përfshijnë shpërblimin e shoqërisë administruese nëpërmjet një marrëveshjeje për ndarjen e tarifave me *broker*-in për kostot e transaksionit ose me kujdestarin për të ardhurat nga huadhënia e aksioneve.
- b) Në përgjithësi, nuk është e nevojshme marrja në konsideratë e marrëveshjes së ndarjes

së tarifave për shpenzimet që janë llogaritur një herë në shifrën e tarifave të vazhdueshme (për shembull, shpërblimi i shoqërisë administruese nëpërmjet marrëveshjes së ndarjes së tarifave me një fond, i cili mbulohet sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të kësaj shtojce). Por, në rastin e sipërmarrjes që investon në sipërmarrje të tjera, çdo marrëveshje për ndarjen e tarifave midis shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose subjektit operator ose shoqërisë administruese të saj merret në konsideratë, nëse nuk është përfshirë në rastet e përcaktuara, sipas pikës 8, më poshtë, të kësaj shtojce.

8. Kur sipërmarrja investon një përqindje të konsiderueshme të aktiveve në sipërmarrje të tjera investimesh kolektive, shifra e tarifave të vazhdueshme merr në konsideratë tarifën e vazhdueshme, që u linden sipërmarrjeve bazë. Sa më poshtë përfshihen në llogaritje:

- a) Përdoret shifra e tarifave të vazhdueshme më e fundit e sipërmarrjes bazë; kjo mund të jetë shifra e deklaruar nga sipërmarrja ose subjekti operator ose shoqëria administruese e saj ose shifra e llogaritur nga një burim i tretë i besueshëm nëse është më e përditësuar se shifra e deklaruar;
- b) Nëse sipërmarrja bazë vihet në shfrytëzim nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose një shoqëri e lidhur, shoqëria administruese bën çmuarjen më të mirë të tarifave, sipas kësaj metodike;
- c) Nëse sipërmarrja bazë nuk përfshihet në përcaktimet e shkronjave “a” ose “b”, të kësaj pike, dhe nuk deklarohet shifrën e tarifave të vazhdueshme, shoqëria administruese ose përdor informacionet e publikuara, që përbëjnë një zëvendësues të arsyeshëm të kësaj shifre (për shembull, raporti i shpenzimeve totale publikuar nga një burim i besueshëm) ose përndryshe kryen një vlerësim më të saktë të nivelit maksimal në bazë të shqyrtimit të prospektit aktual të sipërmarrjes dhe të raportit dhe llogaritjeve më të fundit vjetore të publikuara;
- ç) Kur sipërmarrjet që përfshihen në përcaktimet e shkronjës “c”, të kësaj pike, përbëjnë më pak se 15 % të aktiveve të sipërmarrjes, është e mjaftueshme të përdoret tarifën vjetore të publikuar të administrimit për secilën për këto sipërmarrje në vend të vlerësimit të tarifave të vazhdueshme;
- d) Në çdo rast, shifrave e tarifave të vazhdueshme mund të zvogëlohet në rast se ekziston një marrëveshje (dhe që nuk është reflektuar më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të fondit) për sipërmarrjen investuese për marrjen e një rabati ose retrocedimi të tarifave nga sipërmarrja bazë;
- dh) Në rastet kur sipërmarrja duhet të paguajë tarifa të hyrjes dhe/ose të daljes në lidhje me blerjen ose shitjen e kuotave të një sipërmarrjeje bazë, vlera monetare e këtyre tarifave agregohet për periudhën nën shqyrtim dhe merret në konsideratë në llogaritjen e shifrës së tarifave të vazhdueshme.

9. Në rastin e sipërmarrjes ombrellë çdo nënfond përbërës trajtohet veçmas në kontekst të këtij seksioni, por çdo tarifë që i ngarkohet sipërmarrjes si e tërë ndahet në mënyrë përpjesëtimore mes të gjitha nënfondeve, në mënyrë që të jetë e drejtë për të gjithë

investitorët.

Metodika e llogaritjes (me përjashtim të fondeve të reja)

10. Shifra e tarifave të vazhdueshme është raporti i kostove totale të deklarueshme mbi aktivet neto mesatare të sipërmarrjes, llogaritur sipas këtij seksioni. Shifra shprehet si përqindje me dy shifra pas presjes dhjetore.

11. Shifra e tarifave të vazhdueshme llogaritet të paktën një herë në vit, në mënyrë *ex-post*. Nëse nuk vlerësohet e papërshtatshme të përdoret shifra *ex-post* për shkak të ndryshimeve të konsiderueshme (për shembull, rritje e tarifave të administrimit), mund të përdoret një vlerësim tjetër, gjersa të ketë një shifër të besueshme *ex-post* që reflekton ndryshimin e konsiderueshëm.

12. Bëhet një llogaritje e veçantë për çdo klasë aksionesh ose kuotash, por nëse aksionet ose kuotat e dy a më shumë klasave janë *pari passu*, për to mund të bëhet një llogaritje më vete.

13. Shifra *ex-post* mbështetet në llogaritjen e kostove të kohëve të fundit të përcaktuara nga shoqëria administruese mbi baza të arsyeshme, që janë të përshtatshme për këtë qëllim. Shifra mund të mbështetet në kostot e deklaruar në pasqyrën e veprimtarive të sipërmarrjes, e publikuar në raportin dhe llogaritë më të fundit vjetore ose të ndërmjetme të saj, nëse është mjaftueshmërisht i afërt në kohë; nëse jo, në vend të saj përdoret një llogaritje e krahasueshme në bazë të kostove të ngarkuara gjatë periudhës 12-vjeçare më të fundit. Kostot vlerësohen mbi bazën e të gjitha tatimeve të përfshira, që do të thotë se përdoret vlera bruto e shpenzimeve.

14. Aktivet neto mesatare lidhen me të njëjtën periudhë me kostot dhe llogariten duke përdorur shifrat e mbështetura në aktivet neto të sipërmarrjes në çdo llogaritje të vlerës neto të aktiveve (për shembull, vlerat neto të aktiveve të përditshme, kur kjo është shpeshtësia normale e llogaritjes së miratuar nga autoriteti kompetent i sipërmarrjes).

15. Në rastin kur duhen marrë në konsideratë tarifat e vazhdueshme që i ngarkohen sipërmarrjes bazë:

- a) Shifra e tarifave të vazhdueshme (ose e barasvlershmja) e secilës sipërmarrje bazë përpjesëtimohet sipas përqindjes së vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes, që zë kjo sipërmarrje më datën përkatëse (që është data kur merren shifrat e sipërmarrjes);
- b) të gjitha shifrat e përpjesëtimuara mblidhen me shifrën e tarifave të vazhdueshme të vetë sipërmarrjes investuese, që përbën një total të vetëm (shifra “sintetike” e tarifave të vazhdueshme).

16. Informacionet për shifrat e tarifave të vazhdueshme, që kanë qenë të vlefshme gjatë

viteve/periudhave të mëparshme publikohen në vendin (për shembull, faqen e internetit të shoqërisë administruese), i cili përcaktohet në dokumentin me informacione kryesorë për investitorët, si burimi i përgjithshëm i informacioneve të mëtejshme për investitorët.

Metodika e llogaritjes për fondet e reja

17. E njëjta metodikë zbatohet si për llogaritjen *ex-post*, subjekt i ndryshimeve të mëposhtme:

- a) Nuk zbatohen pikat 13 dhe 14, të kësaj shtojce, dhe në vend të tyre përdoren vlerësimet;
- b) Nëse, sipas mendimit të shoqërisë administruese, të shprehurit e një shifre me dy shifra pas presjes dhjetore ka mundësi të krijojë idenë e gabuar të saktësisë tek investitorët, është e mjaftueshme që kjo shifër të shprehet me një shifër pas presjes dhjetore;
- c) Nëse nuk përcaktohet ndryshe në prospekt, supozohet që për llogari të sipërmarrjes nuk do të merret asnjë rabat apo përjashtim nga tarifa.

18. Shoqëria administruese garanton që saktësia e shifrës së vlerësuar të mbahet nën shqyrtim. Shoqëria administruese përcakton kur është e përshtatshme të fillojë të përdorë shifra *ex-post* në vend të vlerësimeve. Por në çdo rast, ajo shqyrton saktësinë e vlerësimit, jo më vonë se 12 muaj, pas datës së ofrimit për herë të parë për shitje, duke llogaritur një shifër *ex-post*.

SHTOJCA 1.B:

Metodologjia e përgjithshme

1. Treguesi i riskut sintetik dhe shpërblimit duhet të bazohet në paqëndrueshmërinë e fondit.
2. Luhatshmëria vlerësohet duke përdorur kthimet javore të kaluara të fondit ose, nëse nuk është e mundur, duke përdorur kthimet mujore të fondit.
3. Kthimet përkatëse për llogaritjen e paqëndrueshmërisë grumbullohen nga një periudhë model që mbulon 5 vitet e fundit të veprimtarisë së fondit dhe, në rast të shpërndarjes së të ardhurave, matet duke marrë parasysh fitimet përkatëse ose pagimin e dividendëve.
4. Luhatshmëria e fondit do të llogaritet dhe pastaj do të redaktohet në baza vjetore, duke përdorur metodën e mëposhtme standarde:

Luhatshmëria

$$= \sigma_f = \sqrt{\frac{m}{T-1} \sum_{t=1}^T (r_{f,t} - \bar{r}_f)^2}$$

ku kthimet e fondit ($r_{f,t}$) maten mbi T periudha jo mbivendosëse të kohëzgjatjes së viteve $1/m$. Kjo do të thotë $m = 52$ dhe $T = 260$ për kthimet javore, dhe $m = 12$ dhe $T = 60$ për kthimet mujore; dhe ku r_f është mesatarja aritmetike e kthimeve të fondit gjatë periudhave T:

$$\bar{r}_f = \frac{1}{T} \sum_{t=1}^T r_{f,t}$$

5. Treguesi i riskut sintetik dhe shpërblimi korrespondojnë me një numër të plotë të projektuar për të renditur fondin në një shkallë prej 1 deri në 7, sipas nivelit të rritjes së

	Shpjegime grafike ose vizuale	← Shpërblime zakonisht të ulëta Shpërblime zakonisht të larta → ← Rrezik i ulët Rrezik i lartë →							
Shembull i një fondi që bie në kategorinë 2:									
Grafiku i rrezikut dhe shpërblimit		<table border="1"><tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td></tr></table>	1	2	3	4	5	6	7
1	2	3	4	5	6	7			

Shoqëria administruese e fondeve duhet të llogarisin riskut sintetik dhe treguesin e shpërblimit të sipërmarrjes ose të nënfondit në një bashkërendim të rreptë me masat dhe procedurat e

miratuara për qëllime të administrimit të rrezikut dhe të sigurojnë monitorimin e zbatimit korrekt dhe konsekuent të këtij procesi në mënyrë të vazhdueshme.

Llogaritja e riskut sintetik dhe treguesit të shpërblimit të sipërmarrjes ose të nënfondit, si dhe çdo rishikim i mëvonshëm i tij, duhet të dokumentohet në mënyrë adekuate. Shoqëria administruese e fondit i ruan këto të dhëna për këto krahasime minimalisht për pesë vjet.

SHTOJCA 2

Përmbajtja e prospektit SIK për sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike

Fondi i investimeve me ofertë publike	Shoqëria administruese	Shoqëria e investimeve me ofertë publike
1. Informacion lidhur me fondin e investimeve me ofertë publike.	1. Informacion lidhur me shoqërinë administruese, përfshirë të dhëna nëse shoqëria administruese është themeluar në një vend tjetër, të ndryshëm nga vendi i origjinës i sipërmarrjes.	1. Informacion lidhur me shoqërinë e investimeve me ofertë publike.
1.1 Emërtimi i fondit të investimeve	1.1. Emri ose lloji, struktura ligjore, selia e regjistruar dhe selia qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar.	1.1. Emri ose lloji, struktura ligjore, selia e regjistruar dhe selia qendrore nëse është e ndryshme nga selia e regjistruar.
1.2. Data e themelimit të fondit të investimeve, të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Të dhëna mbi kohëzgjatjen, nëse është me afat.
Në rastin e fondit ombrellë të investimeve, emrat dhe objektivat e investimit të nënfondeve.	1.3. Nëse shoqëria administron fonde të tjera të investimeve, tregues i këtyre fondeve të tjera; dhe nëse shoqëria administron shoqëri të tjera të investimeve, të dhëna mbi këto shoqëri të tjera.	
1.4. Vendi ku mund të aksesohet rregullorja e fondit, nëse nuk i bashkëlidhet këtij dokumenti, dhe raportet e pasqyrat financiare vjetore		1.4. Vendi ku mund të aksesohet akti themelues, nëse nuk i bashkëlidhet këtij dokumenti dhe raportet e pasqyrat financiare vjetore dhe të

dhe të ndërmjetme.		ndërmjetme.
1.5. Informacion i shkurtër për mbajtësit e kuotave në lidhje me sistemin tatimor të zbatueshëm për investimin. Informacion nëse zbritja mbahet në burim nga të ardhurat dhe fitimet kapitale nga investimi që u paguhet mbajtësve të kuotave.		1.5. Informacion i shkurtër për aksionarët në lidhje me sistemin tatimor të zbatueshëm për shoqërinë. Informacion nëse zbritja mbahet në burim nga të ardhurat dhe fitimet kapitale që shoqëria u paguan aksionarëve.
1.6. Datat e kontabilitetit dhe të shpërndarjes.		1.6. Datat e kontabilitetit dhe të shpërndarjes.
1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të fondit.		1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë.
	1.8. Emrat dhe postet në shoqëri të personave kyç dhe personelit kyç. Të dhëna për veprimtaritë e tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur janë me rëndësi lidhur me shoqërinë.	1.8. Emrat e personave kyç të shoqërisë. Të dhëna për veprimtaritë e tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur janë me rëndësi lidhur me shoqërinë.
1.9 Vlera minimale e kapitalit të synuar, nëse ka.	1.9. Shuma e Kapitalit të nënshkruar, duke dhënë informacion mbi kapitalin e shlyer.	1.9. Vlera minimale e kapitalit të synuar, nëse ka.
1.10. Të dhëna për llojet dhe karakteristikat kryesore të kuotave dhe në veçanti: natyra e të drejtave (të paluajtshme, të luajtshme ose të tjera) që përfaqëson kuota, karakteristikat e		1.10. Të dhëna për llojet dhe karakteristikat kryesore të aksioneve dhe në veçanti: tituj ose certifikata origjinale që përbëjnë dëshmi të titullit; regjistrim në regjistër ose në llogari,

<p>kuotave: aksion i regjistruar ose i prurësit. Të dhëna të çdo denominimi që mund të parashikohet, tituj ose certifikata origjinale që përbëjnë dëshmi të titullit; regjistrim në regjistër ose në llogari, rastet e vendosjes në likuidim të fondit të investimeve dhe procedurat e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat e mbajtësve të kuotave.</p>		<p>karakteristikat e aksioneve: aksion i regjistruar ose i prurësit. Të dhëna të çdo denominimi që mund të parashikohet, tregues i të drejtave të votës së aksionarëve, rastet e vendosjes në likuidim të shoqërisë së investimeve dhe procedurat e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat e aksionarëve.</p>
<p>1.11. Sipas rastit, të dhëna të tregjeve të rregulluara ose të tregjeve ku janë regjistruar ose tregtohen kuotat.</p>		<p>1.11. Sipas rastit, të dhëna të tregjeve të rregulluara ose të tregjeve ku janë regjistruar ose tregtohen aksionet.</p>
<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së kuotave përfshirë informacione për çdo ofertë fillestare me çmim të pandryshueshëm dhe periudhën e saj.</p>		<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së aksioneve përfshirë informacione për çdo ofertë fillestare me çmim të pandryshueshëm dhe periudhën e saj.</p>
<p>1.13. Procedurat dhe kushtet për riblerjen ose shlyerjen e kuotave, dhe rastet kur mund të pezullohet riblerja ose shlyerja e kuotave. Në rastin e fondeve të investimeve me nënfonde të ndryshme, informacion se si mbajtësi i kuotave mund të transferojë kuotat nga njëri nënfond në tjetrin</p>		

dhe komisionet që zbatohen në raste të tilla.		
1.14. Përshkrim i rregullave për llogaritjen dhe përdorimin e të ardhurave.		1.14. Përshkrim i rregullave për llogaritjen dhe përdorimin e të ardhurave.
1.15. Përshkrim i objektivave të investimeve, përfshirë objektivat financiarë (p.sh., rritjen e kapitalit ose të ardhurave), politikën e investimeve (p.sh., specializimi në sektorë gjeografikë ose industrialë), kufizimet e politikës së investimeve dhe të dhëna mbi mënyrën dhe instrumentet apo të drejtat e huamarrjes që mund të përdoren në administrimin e fondit të investimeve.		1.15. Përshkrim i objektivave të investimeve, përfshirë objektivat financiarë (p.sh., rritja e kapitalit ose të ardhurat), politikën e investimeve (p.sh., specializimi në sektorë gjeografikë ose industrialë), kufizimet e politikës së investimeve dhe të dhëna mbi mënyrën dhe instrumentet apo të drejtat e huamarrjes që mund të përdoren në administrimin e shoqërisë.
1.16. Rregullat për vlerësimin e aktiveve.		1.16. Rregullat për vlerësimin e aktiveve.
1.17. Përcaktimi i vlerës neto të aktiveve për kuotë dhe çmimit të shitjes ose emetimit dhe i çmimit të riblerjes ose shlyerjes së kuotave, në veçanti: <ul style="list-style-type: none"> - Metoda dhe shpeshtësia e llogaritjes së këtyre çmimeve, - Informacion lidhur me komisionet për shitjen ose emetimin dhe riblerjen ose shlyerjen e kuotave, (komisionet 		1.17. Përcaktimi i vlerës neto të aktiveve për aksion, në veçanti: <ul style="list-style-type: none"> - Metoda dhe shpeshtësia e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve, - Mënyrat, vendet dhe shpeshtësia e publikimit të vlerës neto të aktiveve për çdo aksion dhe të çmimeve të tregut.

<p>hyrëse dhe dalëse)</p> <p>- Mënyrat, vendet dhe shpeshësia e publikimit të këtyre çmimeve.</p>		
<p>1.18. Informacione lidhur me mënyrën, shumën dhe llogaritjen e shpërblimit që fondi i investimit i paguan shoqërisë administruese, depozitarit ose të tretëve, dhe rimbursimin e kostove që i bën fondi i investimeve shoqërisë administruese, depozitarit ose të tretëve.</p>		<p>1.18. Informacione lidhur me mënyrën, shumën dhe llogaritjen e shpërblimit që shoqëria u paguan personave kyç, shoqërive administruese, depozitarit ose të tretëve, dhe rimbursimin e kostove që u bën shoqëria anëtarëve të këshillit të administrimit, depozitarit ose të tretëve.</p>

2. Informacion lidhur me depozitarin:

- 2.1. Identiteti i depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe përshkrim i detyrave të tij dhe i konflikteve të interesit që mund të lindin;
- 2.2. Përshkrim i funksioneve të ruajtjes, të cilat depozitari i ka deleguar, lista e të deleguarve dhe të nëndeleguarve dhe çdo konflikt interesi që mund të lindë nga delegimi;
- 2.3. Deklaratë se investitorëve u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, informacione të përditësuara, në lidhje me pikat 2.1 dhe 2.2 të kësaj pike.

3. Informacion lidhur me shoqëritë e jashtme të administrimit të portofolit, të cilët japin këshilla sipas kontratave të nënshkruara, që paguhen nga aktivet e sipërmarrjes:

- 3.1. Emri ose forma e firmës ose emri i shoqërisë së administrimit të portofolit;
- 3.2. Dispozitat thelbësore të kontratës me shoqërinë administruese ose shoqërinë e investimeve që mund jenë me rëndësi për mbajtësit e kuotave ose aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, përjashtuar dispozitat në lidhje me shpërblimin e punës;
- 3.3. Veprimtari të tjera të rëndësishme.

4. Informacion në lidhje me masat rregulluese për kryerjen e pagesave mbajtësve të kuotave, riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe vendosjen në dispozicion të

informacionit lidhur me sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike. Gjithashtu, kur kuotat marketohen në një vend tjetër, këto informacione jepen lidhur me këtë vend në prospektin SIK të publikuar atje.

5. Informacione të tjera për investimet:

- 5.1. Ecuria historike e sipërmarrjes (nëse ka) – ky informacion mund të përfshihet brenda prospektit ose t'i bashkëlidhet;
- 5.2. Profili i investitorit tipik, për të cilin është krijuar sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ose nënfondi.

6. Informacione ekonomike:

- 6.1. Shpenzime ose tarifa të mundshme, përveç komisioneve dhe pagesave të përmendura në pikën 1.17 të kësaj shtojce, duke bërë dallimin midis atyre që paguajnë mbajtësit e kuotave dhe atyre që paguhen nga aktivet e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike.